



# FORUM I BASHKËSISË ME 11 HAPA



DORACAK

Për botuesin:  
Dushica Perishiq, drejtoreshë ekzekutive e BNJVL

Titulli:  
**Doracak – Forum i bashkësisë me 11 hapa**

Autorë:  
Kristina Haxhi – Vasileva, Goran Angellov,  
Svetlana Milenkova, Lulzim Haziri,  
Boris Sharkovski, Igor Taseski,  
Irena Spirkovska dhe Doço Georgiev Mihaillov

Lekturoi dhe korrigjoi:  
DTPU Moment mal DOOEL import– eksport Shkup

Përkthyes të gjuhës angleze dhe shqipe:  
DTPU Moment mal DOOEL import– eksport Shkup

Tirazhi:  
1000

Dizajni dhe botimi:  
Brigada dizajn, Shkup

Ky publikim/doracak është rezultat i realizimit të programit “Forume në bashkësi”, i dedikuar për avancimin e pjesëmarrjes së qytetarëve në sjelljen e vendimeve në nivel lokal, i mundësuar me mbështetjen financiare nga Agjencia zvicerane për bashkëpunim dhe zhvillim (SDC).



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development  
and Cooperation SDC

CIP-Katalogizacija vo publikacija  
Nacionalna i univerzitetska biblioteka “Св. Климент Охридски”, Скопје  
352.342.571(497.7)

FORUM i bashkësisë me 11 hapa: doraçak / Krisitna Haxhi-Vasileva ... [и др.]. – Shkup:  
Bashkësia e njërive të vetëqeverisjes lokale  
të Republikës së Maqedonisë – BNJVL, 2010.- 40 стр.; 21см

Превод на делото: Форум на заедницата во 11 чекори: прирачник /  
Кристина Хаџи-Василева ... [и др.]. – Авторë: Krisitna Haxhi-Vasileva,  
Goran Angelov, Svetlana Milenkova, Lulzim Aziri, Boris Sharkovski, Igor Taseski,  
Irena Spirovska and Doço Georgiev Mihailov.- Содржи и : Annex 1-35

ISBN 978-9989-186-53-0

Нахџи-Василева, Кристина [автор]  
Локална самоуправа-Граѓанска партиципација-Македонија  
COBBIS.MK-ID 85897738

## Përmbajtja

Hyrja	5		
<b>KREU 1</b> PËR ÇKA SHËRBEËN KY DORACAK DHE KUJT I DEDIKOHET?	6	<b>HAPI i 3</b>	
<b>KREU2</b> PJESËMARRJA QYTETARE: ÇFARË ËSHTË KJO DHE PSE?	6	Formimi i ekipit për zbatimin e forumit	15
<b>KREU 3</b> FORUM I BASHKËSISË : ÇFARË ËSHTË AI DHE PSE ËSHTË I NEVOJSHËM?	7	A) Zgjedhja e koordinatorit të komunës/donatorit	16
3.1 Çka është forumi i bashkësisë? (Konceptet themelore)	7	B) Zgjedhja e moderatorit	16
3.2 Për çka shërben forumi?	8	C) Zgjedhja e bashkëmoderatorit	17
3.3 Llojet e forumeve	9	Ç) Zgjedhja e anëtarëve të grupit operativ	18
3.4 Mënyra e punës dhe struktura e forumit	10	D) Zgjedhja e personit për marrëdhënie me publikun	18
<b>KREU 4</b> 10 HAPA PËR ZBATIMIN E FORUMEVE NË BASHKËSI	13	<b>HAPI i 4</b>	
<b>HAPI i 1</b>		Mobilizimi i bashkësisë	19
Vendim për forumin në bashkësi / Identifikimi i nevojës për forum	13	A) Kush është kompetent për mobilizimin e qytetarëve? Si?	19
A) Inciatori i forumit	13	<b>HAPI i 5</b>	
B) Tema e forumit	14	Organizimi i sesionit të parë të forumit	21
<b>HAPI i 2</b>		<b>HAPI i 6</b>	
Mjetet për organizimin e forumit	15	Organizimi i sesionit të dytë të forumit	24
		FORUMI i PROJEKTIT	25
		FORUMI NDËRKOMUNAL	25
		FORUMI BUXHETOR	

HAPI i 7	
Organizimi i sesionit të tretë të forumit	25
FORUMI I PROJEKTIT	25
FORUMI BUXHETOR	26
HAPI i 8	
Organizimi i sesionit të katërt të forumit	27
FORUMI I PROJEKTIT	27
FORUMI BUXHETOR	27
HAPI i 9	
Organizimi i sesionit të pestë të forumit	28
FORUMI I PROJEKTIT	28
FORUMI BUXHETOR	29
HAPI i 10	
Realizimi i projekteve të zgjedhura	30
HAPI i 11	
Organizimi i seancës së mëvonshme	32
<b>KREU 5</b>	
<b>SFIDAT E PROCESIT TË FORUMIT</b>	<b>32</b>
Lista e Anekseve (të dhëna në CD)	40

## Hyrje

Forumi i bashkësisë paraqet vegël për involvimin e suksesshëm të qytetarëve në procesin e sjelljes së vendimeve në nivel komunal. Sipas funksionimit të këtillë është zbatuar në Zvicër dhe në Bullgari, me çka është bartur, adaptuar dhe aprovuar, në Maqedoni. Në bazë të përvojës në zbatimin e tij në Maqedoni, në vitin 2010 me propozim të Bashkësisë së njësiteve të vetëqeverisjes lokale të Republikës së Maqedonisë – BNJVL, njësitë e vetëqeverisjeve lokale filluan me ndryshimin dhe plotësimin e Statuteve të tyre edhe atë në pjesën e cila e rregullon pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të qytetarëve, duke i shtuar edhe forumet në bashkësi, si një formë shtesë e involvimit të qytetarëve në sjelljen e vendimeve me rëndësi lokale.

Përvoja me forumet filloi me zbatimin e programit “Forume në bashkësi” gjatë vitit 2006 nga ana e Agjencisë zvicerane për zhvillim dhe bashkëpunim menjëherë pas fillimit të fazës së parë nga procesi i shumëpritur i decentralizimit. Ky program kishte për qëllim t’i japë mbështetje këtij procesi përmes ofrimit të modelit për zhvillimin e bashkësisë me pjesëmarrjen aktive të qytetarëve. Përmes modelit të “Forumit të bashkësisë” u ofrua platforma përmes së cilës qytetarët do të mund ta përmirësojnë jetën e tyre me idetë dhe pjesëmarrjen personale, ndërsa administrata lokale do të praktikojë qeverisje involvuese, përgjegjëse dhe lokale e cila ndërton besim.

Komunat Gjorçe Petrov, Kërçovë dhe Prilep janë zgjedhur si komuna ku për herë të parë u zbatua modeli i forumeve.

Në vitin 2007, me hyrjen e një pjese të komunave në fazën e dytë të decentralizimit fiskal, u mundësua liri më e madhe për planifikimin hartues dhe buxhetor sipas nevojave. Tre vitet e ardhshme (2008/2010), përmes thirrjeve publike dhe sigurimit të pjesëmarrjes së pjesërishme

financiare nga ana e komunave, gjithsej 22 komuna (Aerodromi, Berova, Manastiri, Bogovina, Gostivari, Dibra, Dollneni, Karbinci, Konçe, Koçani, Krusheva, Makedonski Brod, Mogilla, Novaci, Novosella, Radovishi, Saraj, Shën Nikolla, Strumica, Çairi dhe Çashka) u inkuadruan në program. Autoritetet komunale e aprovuan modelin dhe zbatonin forume me tema të ndryshme në mesin e së cilave edhe buxheti i komunës apo problemet/çështjet e përbashkëta të dy komunave fqinje.

Përvoja me këto komuna tregoi se forumi si model i pjesëmarrjes së qytetarëve mund të zbatohet në punën e komunës dhe, si rezultat i kësaj, nga ana e BNJVL-së përmes procesit transparent në të cilin u inkuadruan ekspertë nga sfera e vetëqeverisje lokale, përfaqësues komunal dhe përfaqësues nga sektori joqeveritar, janë përgatitur dhe propozuar në të gjitha njësitet e vetëqeverisjes lokale për miratim:

1 – Propozim-vendim për ndryshimin e Statutit të njësiteve të vetëqeverisjes lokale me të cilën vendoset forumi si mënyrë e pjesëmarrjes së qytetarëve dhe

2- Propozim-rregullore për organizimin dhe mirëmbajtjen e forumeve të bashkësive në NJVL.

Me miratimin e këtyre dokumenteve nga ana e komunave u institucionalizua forumi si model i pjesëmarrjes qytetare në aktet komunale dhe u hap nevoja e përgatitjes së këtij doracaku. (Sipas nenit 24 nga Rregullorja u vërtetua përgatitja e doracakut)

Qëllimi i këtij doracaku është që t’ju ndihmojë komunave në zbatimin e forumit në bashkësi dhe atë ta bëjnë në mënyrë të lehtë dhe të thjeshtë.

## KREU 1 PËR ÇKA SHËRBEËN KY DORACAK DHE KUJT I DEDIKOHET?

Ky doracak u dedikohet njësiteve të vetëqeverisjes lokale (NJVL) të cilët e ndryshuan Statutin e tyre dhe e vendosën forumin në bashkësi si formë e pjesëmarrjes publike të të gjithë qytetarëve në komunë. Për nga tematika, doracaku përpiqet në mënyrë të qartë dhe të thjeshtë t'i fusë kryetarët e komunave, këshilltarët dhe punonjësit komunalë gjegjësisht të gjithë personat e përfshirë nga NJVL-ja, në procesin e realizimit të forumeve të ardhshme në bashkësi, duke filluar nga vendimi deri tek hapat praktikë se si të zbatohet forumi. Qasja e propozuar "forumore" mbështetet me shembuj dhe rekomandime të cilat janë treguar si funksionale gjatë zbatimit të 26-të forumeve në komunat në Maqedoni dhe të cilat mund t'ju shërbejnë komunave.

Shpresojmë se ky publikim do t'ju ndihmojë të gjitha komunave të cilat do të përfshihen me krijimin e mundësive për shfrytëzimin e forumit gjatë sjelljes së vendimeve të rëndësishme për bashkësinë.



## KREU 2 PJESËMARRJA E QYTETARËVE: ÇFARË ËSHTË KJO DHE PSE?

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë e cila i garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut njëkohësisht i përcakton sferat gjegjësisht kompetencat komunale në zgjidhjen e së cilave qytetarët marrin pjesë drejtpërsëdrejti dhe përmes përfaqësuesve<sup>1</sup>.

Ligji për vetëqeverisjen lokale<sup>2</sup> në nenet 25, 29 dhe 30 i thekson format themelore të pjesëmarrjes së qytetarëve (iniciativa qytetare, tubime të qytetarëve, referendum, parashtrësia, propozime, tribuna publike dhe anketa) ndërsa në nenin 42 tregon për publikun në punën e Këshillit.

Pjesëmarrja e qytetarëve paraqet involvimin e qytetarëve, banorëve të një bashkësie, në procesin e sjelljes së vendimeve të cilat në mënyrë të drejte ose indirekte ndikojnë në jetën e tyre në bashkësi. Më pas shfrytëzohen mekanizma për shqyrtimin e mendimeve dhe nevojave të qytetarëve të cilat adaptohen sipas nevojës.

Për ata të cilët zakonisht i sjellin vendimet (kryetari i komunës, këshilltarët, qeveria etj.) involvimi i qytetarëve paraqet ndërtimin, gjegjësisht sigurimin e mbështetjes së gjerë për idetë dhe zgjidhjet të cilat i propozojnë. Nga ana tjetër, për qytetarët pjesëmarrja nënkupton mundësi për ndikim mbi vendimet. Në këtë mënyrë ndërtohen ura bashkëpunimi midis (në rastin konkret) vetëqeverisjes lokale dhe qytetarëve dhe zmadhohet transparenca. Ajo që është më e rëndësishme është se pjesëmarrja e qytetarëve ndihmon në përmirësimin e shërbimeve komunale të cilat ata i fitojnë, gjegjësisht shfrytëzojnë.

Është e nevojshme dyja palët të jenë veprues aktiv që të ketë pjesëmarrje të vërtetë të qytetarëve. Kjo do të thotë se duhet, para së gjithash, pushtet lokal i cili do të jetë i hapur për një lloj të këtyllë të qeverisjes lokale të ketë në dispozicion mekanizma që ta bëjë këtë dhe qytetarë ak-

<sup>1</sup> Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, Amendamenti 17, pika 1, „Gazeta zyrtare“, 2003

<sup>2</sup> Ligji për vetëqeverisje lokale, „Gazeta zyrtare“ nr. 5, 29 janar 2002

tiv të cilët janë të gatshëm të ndajnë kohë dhe energji për bashkëpunim me komunën.

Procesi i vendosjes së përbashkët e ndan përgjegjësinë për vendimet, me ç'rast autoritetet lokale nuk janë bartësit e vetëm të "barrës", ndërsa qytetarët bëhen të vetëdijshëm për mundësitë reale të administratës komunale kur zgjedh probleme ose ndërmerr iniciativa. Megjithatë, mekanizmat për involvimin e qytetarëve në vendimmarrje nuk zbatohen gjithnjë, pasi që kjo do të thotë rindarje e fuqisë dhe vendosje e marrëdhënieve të ndryshme. Mungesa e kapaciteteve (njerëzore, financiare, hapësinore etj.) e autoriteteve, gjithashtu, mund ta vështirësojë komunikimin e autoriteteve me qytetarët, veçanërisht në komunat rurale.

Me procesin e decentralizimit, zmadhohet numri i kompetencave të cilat bien nën ingerencat e vetëqeverisjes lokale, me çka akoma më shumë theksohet nevoja nga konsultimi dhe komunikimi i rregullt me qytetarët për tema dhe çështje të sferave të ndryshme.

Shfrytëzimi i mekanizmave për përfshirjen e qytetarëve është me rëndësi kyçe në mjediset multietnike në të cilat mosgjidhja e problemeve praktike nga jeta e përditshme e qytetarëve mund marrë parashenjë etnike dhe të shpie në tension të panevojshëm.

Mekanizmat e theksuara në Ligj janë minimumi më i nevojshëm që të merren parasysh mendimet e qytetarëve. Në dispozicion të punonjësve komunalë janë një sërë mjetesh të tjera dhe mënyra të cilat mund t'i shfrytëzojnë ata sipas nevojës dhe mundësive. Në këtë drejtim, "forumin" duhet shikuar si një vegël të cilën kryetarët e komunave mund ta shfrytëzojnë në angazhimet e tyre që ta zhvillojnë bashkësinë, të sigurojnë mirëqenien e qytetarëve dhe të praktikojnë menaxhim të mirë.

## KREU 3

# FURUMI I BASHKËSISË : ÇFARË ËSHTË AI DHE PSE ËSHTË I NEVOJSHËM?

### 3.1 Çfarë është forumi i bashkësisë? (Konceptet themelore)

Forum i bashkësisë paraqet edhe një formë të involvimit të qytetarëve nga ana e vetëqeverisjes lokale në sjelljen e vendimeve të cilat janë të rëndësishme për jetën e tyre dhe për vetë bashkësinë.

Forum i bashkësisë shërben që komuna të zhvillojë praktika transparente të vendosjes me përfshirjen e qytetarëve, por edhe qytetarët të zhvillojnë ndjenjën e përgjegjësisë për shpenzimin e mjeteve komunale. Tek format e tjera të pjesëmarrjes së qytetarëve, në fund vendimin e sjellin autoritetet lokale, ndërsa qytetarët konsultohen, por propozimet nuk pranohen gjithmonë. Te Forumi, qytetarët së bashku me autoritetet lokale e sjellin vendimin.

Forumet organizohen për shkak debatit publik apo arritjes së pëlqimit të opinionit lokal për prioritetet e propozuara në dokumentet për zhvillim lokal strategjik, për debate publike për problemet dhe përcaktimet e zgjidhjeve dhe prioriteteve, si dhe për propozimin dhe zgjedhjen e projekteve apo për shkak zhvillimit të projekteve me interes për bashkësinë.

Forum i paraqet një varg prej 6 takimeve të qytetarëve (sesioneve3) në të cilat përmes diskutimeve të strukturuar pjesëmarrësit do të elaborojnë probleme dhe ofrojnë zgjidhje për to, njëkohësisht duke dhënë edhe rekomandime për institucionet lokale. Forumi mbahet në së paku 5 (pesë) sesione nga të cilat në sesionin e pestë vendoset për çështjet dhe temat e forumeve. Sesioni i gjashtë (i fundit) është sesion informativ qëllimi i së cilit është t'i njoftojë qytetarët për zgjidhjet e realizuara nga forumi, pas realizimit të tyre.



Forumi e reflekton bashkësinë, pasi që në të pritet të marrin pjesë pjesëmarrës nga grupet shoqërore, të grupmoshave, etnike, gjinore, profesionale, religjioze dhe grupeve të tjera, varësisht nga ajo se cilat grupe janë të përfaqësuara në bashkësi.

Për shembull, në komunat rurale në të cilat zbatohet forumi, ekzistonin masa punëtore si, bujqësia, vreshtaria, pemëtaria të cilat mungonin në komunat urbane.

Për shkak organizimit më efikas dhe më të mirë të forumit formohen grupe të punës dhe grup operativ.

Veçoritë kryesore të qasjes forumore janë:

1. Forumet funksionojnë përmes diskutimeve të strukturuar të cilat janë të hapura për të gjithë qytetarët. Diskutimet i drejton moderator<sup>3</sup> i pavarur i jashtëm dhe ndjekin rend dite fiks.
2. Pjesëmarrësit në forumet strukturohen në grupe, të ashtuquajtura "tavolina pune", sipas interesave të tyre sociale dhe ekonomike. Administrata lokale përfaqësohet në forum me të drejta të barabarta (vota) si dhe pjesëmarrësit e tjerë.
3. Forumet përpunojnë zgjidhje dhe ju japin rekomandime institucioneve lokale (kryesisht administratës komunale dhe Këshillit komunal, por edhe institucioneve të tjera).
4. Forumi ka qasje demokratike. Vendimet për atë se cilat zgjidhje do të realizohen/financohen i sjell forumi, gjegjësisht qytetarët, përmes tavolinave të tyre të punës.
5. Forumet ndërtojnë partneritet, pasi që grupet e ndryshme me interes të njëjtë apo të ngjashëm mund të punojnë së bashku.
6. Diskutimet e forumit çojnë nga rezultatet. Forumi i zhvillon projektet dhe dorëzon rekomandime në pajtim me temën
7. Projektet forumore realizohen me mjetet financiare të siguruar nga komuna dhe/apo nga personat e interesuar juridik dhe fizik

<sup>3</sup> Koncepti moderator këtu ka kuptim gjenerik dhe nuk na tregon gjininë mashkullore. Që të shmanget mbingarkesa e tekstit, të gjitha emrat e tipit nomina agentis janë dhënë në formën dhe kuptimin e tyre gjenerik .

të cilët janë të gatshëm financiarisht të mbështesin projekte me interes të bashkësisë përmes njësitit të vetëqeverisje lokale.

Forumi fillon me temë të përbashkët apo problem në të cilin përmes diskutimeve të strukturuar, të udhëhequra nga moderatori i jashtëm, neutral, në vend neutral me karakter publik, qytetarët mundohen të gjejnë zgjidhje. Më pas pjesëmarrësit i harmonizojnë mendimet e tyre, sjellin vendime, përcaktojnë prioritetet dhe vendosin cilat nga këto vendime do të realizohen. Ata kanë në dispozicion ekspertizë, ndërsa moderatori i çon nëpër proces dhe marrin mbështetje. I gjithë procesi është publik, i hapur dhe transparent.

### 3.2 Për çka shërben forumi?

Forumi është vetëm një nga mënyrat për involvimin e qytetarëve në procesin e sjelljes së vendimeve. Varësisht nga konteksti dhe qëllimet të cilat duhet arritur duhet të zgjidhet edhe mjetet përkatës. Forumi më së miri është të shfrytëzohet kur duhet të:

- » përcaktohen prioritetet në kuadër të dokumenteve strategjike të komunës, si dhe të parashihen prioritetet e ardhshme strategjike të komunës dhe në mënyrë përkatëse të planifikohet dhe të përgatitet buxheti,
- » zgjidhen çështje të cilat i tangojnë grupet e ndryshme me interes, ndërsa nevoja e zgjidhjes së tyre është shumë e rëndësishme;
- » kur interaksioni midis grupeve të ndryshme shoqërore në formulimin e projekteve dhe zbatimin vlerësohet se do të jetë konstruktiv;
- » kur është e rëndësishme transparenca e procesit dhe llogaridhënia e iniciatorit të forumit, si dhe pjesëmarrja e qytetarëve;
- » kur ekziston nevoja nga involvimi i drejtpërdrejtë i bashkësisë më të gjerë;
- » Kur nevojat e palëve të interesuara janë të shumta dhe ato duhet të trajtohen përmes një debati të strukturuar.

Forumi është projektuar për forcimin e pjesëmarrësve që vetë të sjellin vendime. Forumi i sjell në një vend grupet me interes të cilat përndryshe nuk do të takoheshin dhe nuk do të kishin komunikim të ndërsjellë dhe në këtë mënyrë e ndërron sistemin e vendosur të debatit publik në bashkësi.

Forumi parasheh komunikim konstant të dyanshëm në periudhë të caktuar kohore për tema konkrete. Në këtë mënyrë përforcohen vlerat demokratike të dialogut dhe ndërtimi i besimit midis qytetarëve dhe autoriteteve lokale.

Forumi nuk rekomandohet të shfrytëzohet kur:

- ▶▶ është e nevojshme shpejt të sillen vendim,
- ▶▶ kur bëhet fjalë për çështje shumë teknike të cilën mund ta zgjedhin vetëm ekspertë
- ▶▶ kur diskutohet për çështjet afariste të cilat prekin bizneset (përveç se kur bëhet fjalë për partneritet publik-privat)
- ▶▶ kur numri i palëve të prekura është i kufizuar.

Forumi shërben që edhe qytetarët të njoftohen me punën e komunës, veçanërisht shpenzimin e mjeteve. Përmes Forumit qytetarët prej së afërmi do ta shohin se nuk është e mundur të plotësohen nevojat e të gjithë qytetarëve, në kushte të mjeteve të kufizuara dhe prandaj në sjelljen e vendimeve duhet të bëhen kompromise dhe të respektohet vullneti i shumicës.

### 3.3 Llojet e forumeve

Në pajtim me temat të cilat diskutohen, Forumi mund të jetë:

#### • Forum Projektues

Rezultatet e forumit projektues janë një numër i caktuar i projekteve dhe rekomandimeve të cilat kontribuojnë për zhvillimin e bashkësisë në tërësi. Forumi projektues organizohet kur duhet definuar prioritetet midis disa temave dhe projekteve të cilat janë të domosdoshme të zgjidhen në njësitin e vetëqeverisje lokale dhe bashkësinë.

Në forumet projektuese të zbatuara deri më tani më së shpeshti është zgjedhur tema e infrastrukturës, në variante të ndryshme: komunale, arsimore, urbane etj. Projektet të cilat u zgjedhën sillleshin nga ndërtimi/renovimi i parqeve, vendosja e pajisjes urbane, deri tek renovimi i ndërtesave shkollore.

Zakonisht forumi projektues ka të bëjë me vëllimin e gjerë të interesave në bashkësi. Qëllimi i tij është të kontribuojë nga zhvillimi i përgjithshëm i bashkësisë përmes diskutimit participues dhe projekteve zhvilluese të cilat dalin nga bashkësia.

#### • Forum tematik

Rezultati i forumit tematik janë rekomandimet të cilat kontribuojnë për zhvillimin e çështjes konkrete në bashkësi. Forumet tematike orientohen nga tema veç më e caktuar në të cilën përbëhet ndonjë problem specifik dhe aktual në njësitin e vetëqeverisjes lokale. Në këtë tip të forumit formohen tavolina pune për grupet të cilat janë të prekur nga problemi.

Forumi tematik i grumbullon në një vend grupet “për” dhe “kundër” një vendimi të caktuar, si dhe të papërcaktuarit të cilët janë involvuar. Gjatë sesioneve grupet punuese i nxjerrin argumentet e tyre edhe



përmes “luftës” demokratike vijnë deri tek zgjidhja “fituese”. Zakonisht për forumin tematik është e nevojshme ndonjë temë kontestuese dhe e ndjeshme e cila është e rëndësishme për bashkësinë, por e ndan të njëjtën në grupe të ndryshme të cilat kanë qëndrime të kundërta.

#### • Forumi ndërkomunal

Forum i ndërkomunal organizohet kur dy ose më shumë njësite fqinje të vetëqeverisjes lokale kanë temë diskutimi të ngjashme apo të njëjtë, ndërsa me metodën e bashkëpunimit ndërkomunal mundësohet që sa më shpejtë, në mënyrë më ekonomike dhe më efikase të realizohen konstatimet nga forumi. Në forumin ndërkomunal përveç temës së njëjtë për diskutim, nevojiten zgjidhjet të cilat ofrohen të jenë të përbashkëta për të gjitha komunat e involuara në forum, e jo të ofrohen zgjidhje të njëjta paralele. Forumet ndërkomunale zbatohen nëse ekzistojnë çështje konkrete të cilat janë me interes të përbashkët dhe praktikisht të nevojshme.

Për shembull, komunat Mogila dhe Novaci kanë zbatuar formum ndërkomunal ku tema ka qenë “Grumbullimi i mbeturinave”. Forumi përfundoi me formimin dhe pajisjen e Ndërmarrjes së përbashkët publike komunale të Mogillës dhe Novacit.

#### • Forumi buxhetor

Rezultat i forumit buxhetor është buxheti i miratuar komunal në konsultim me qytetarët. Në forumin buxhetor temë diskutimi është buxheti i NJVL për vitin e ardhshëm. Tryezat e punës janë strukturuar sipas palëve të involuara nga buxheti i NJVL-së apo sipas kompetencave dhe financimit të së njëjtave. Forumi buxhetor kërkon përfshirje më të madhe të institucioneve lokale dhe ekspertëve.

Forum buxhetor është mundësia më e mirë komuna të tregojë nivel të lartë të transparencës dhe dhënies së llogarisë para qytetarëve, pasi që në sesionet shkallë pas shkallë shqyrtohet buxheti i komunës, me numra dhe aktivitete konkrete. Kjo është mundësi e mirë komuna të përpilojë buxhet varësisht nevojave të qytetarëve. Për qytetarët kjo është mundësi të shohin se planifikimi i mjeteve të kufizuara nuk është aspak i lehtë dhe se komuna nuk mund t’i realizojë të gjitha prioritetet.

Për shembull, në komunën e Strumicës, me ndihmën e forumit buxhetor 24 ide të qytetarëve u bënë pjesë e buxhetit të komunës.

Disa nga linjat buxhetore, p.sh. në pjesën e investimeve kapitale, mund të mbështeten me fond projektues, kështu që edhe forumi buxhetor mund të jetë “projektues”.


### 3.4 Mënyra e punës dhe struktura e forumit

Forum i përbëhet prej 6 takimeve të qytetarëve (zakonisht një herë në muaj, por varësisht nga komuna konkrete mund të vendoset edhe dinamikë e ndryshme) në të cilat qytetarët diskutojnë për çështje të rëndësishme me interes të përbashkët.

Për shembull, tek forumi buxhetor dinamika e sesioneve diktohen nga kalendari buxhetor, gjegjësisht nga afati i caktuar ligjor për përpilimin dhe sjelljen e buxhetit të komunës.

Forum i fillon me temë apo problem të përbashkët për të cilin përmes diskutimeve të strukturuar qytetarët mundohen të gjejnë zgjidhje. Takimet forumore zhvillohen në vend neutral me karakter publik dhe drejtohen nga ndonjë moderator neutral i cili nuk është involvuar në vendimet/rezultatet e forumit. Qytetarët në forum marrin pjesë sipas tryezave në të cilat ulen (tryezave të punës), të cilat paraqesin palë të ndryshme (punonjës shëndetësorë, zjarrfikës, bujq, prindër, arsimtarë, të rinj, pensionistë etj.). Tryezat e punës janë vegla përmes së cilës funksionon Forumi, të gjitha vendimet sillen nga ana e tryezave të punës edhe sipas rregullit: “Një tavolinë = një votë”! Të gjithë pjesëmarrësit në Forum në kuadër të tavolinave të punës kanë mundësi ta japin mendimin e tyre dhe bashkërisht të sjellin vendim për ndonjë çështje të caktuar dhe si qëndrim të tavolinës së punës e prezantojnë para forumit. Në këtë mënyrë pjesëmarrësit kontribuojnë në punën e forumit si grupe të interesuara, e jo si individë, me çka kontribuohet drejt diskutimit të fokusuar. Përbërja e forumit varet nga tema, gjegjësisht përmbajtja e vetë forumit. Gjatë forumit pjesëmarrësit i shprehin mendimet e tyre për temën, gjegjësisht për problemin i cili trajtohet në forum, debatojnë

dhe japin argumente për qëndrimet e tyre, i harmonizojnë mendimet e tyre dhe sjellin vendime, përcaktojnë prioritetet dhe vendosin se cilat nga këto vendime do të realizohen. Ata kanë në dispozicion ekspertizë nga vetë forumi, duke e marrë parasysh se në forum marrin pjesë persona profesionistë me ekspertizë të ndryshme. Sipas nevojës, varësisht nga tema dhe problemi për të cilin diskutohet, ftohen edhe ekspertë të jashtëm. Ekspertët janë persona të cilët kanë njohuri profesionale për temën/problemin për të cilin diskutohet. Njëherit, krahas asaj që moderatori dhe bashkëmoderatori i drejtojnë pjesëmarrësit nëpër proces, ata, gjithashtu, sigurojnë informacione. I gjithë procesi është publik, i hapur dhe transparent.



Struktura e forumit projektues tipik është paraqitur në fotografinë 1.

Forumit është i hapur për të gjithë qytetarët e interesuar të komunës. Ata qytetarë të cilët nuk dëshirojnë në mënyrë aktive të marrin pjesë në forum (nuk kanë kohë ose nuk ndjehen këndshëm) dhe të ulën në tryezat e punës, mund ta ndjekin forumin si publik. Publiku i forumit ka të drejtë të kyçet në diskutimet, por nuk ka të drejtë të sjell vendime. Mysafirët mund të jenë përfaqësues të ministrive, NJVL të tjerë, të donatorit etj.

Në një sesion forumi mesatarisht formohen 10 tavolina pune, me së paku 3 pjesëmarrës nga secila palë e involvuar. Në mesin 10 nga Rregullorja përcaktohet numri i pjesëmarrësve në përpjesëtim me numrin e banorëve të komunës, me qëllim të sigurimit të legjitimitetit të vendimeve të sjella në forum. Në këtë mënyrë forumi është ngjarje e madhe publike i cili përfshin së paku 40 deri më shumë se 100 persona (bashkë me mysafirët, mediet dhe ekspertët).



Në zbatimin e deritanishëm të forumeve kishte raste të më shumë se 200 të pranishmëve (komuna e Dibrës, komuna e Çairit), por edhe shembuj me dyzetë të pranishëm. Megjithatë, konkludim është se numri tejet i madh i të pranishmëve e bën forumin të pamundur për punë, ndërsa numri shumë i vogël e bën jolegjitim. Nga kjo del se numri optimal i cili do t'i japë Forumit legjitimitet dhe reprezentativ është prej 60-100 qytetarë, varësisht nga madhësia e komunës.

Dy nga tryezat e punës janë të ashtuquajtura të domosdoshme: tryeza e grupit operativ dhe tryeza e administratës komunale.

Grupi operativ ka tryezë të veçantë, por përfaqësuesit e së njëjtës nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në diskutimet e forumit. Ata janë mbështetje logjistike e forumit dhe e moderatorit dhe bashkëmoderatorit. Ata e përgatisin sallën dhe materialet para se të fillojë forumi, ndërsa gjatë sesionit mund të ndihmojnë me prezantimet, teknikën, tablotë, listat e pjesëmarrësve, ndarjen e materialeve etj.

Administrata komunale ka të drejtë të barabartë të marrë pjesë në sjelljen e vendimeve të forumit si dhe tryezat e tjera të punës, por roli i saj është shumë më i rëndësishëm, pasi që në Forum diskutohen çështjet në kompetencë të komunave dhe është e nevojshme të jenë prezent ata të cilët disponojnë me informacionet. Në Forum mund të ndodh qytetarët të diskutojnë për ndonjë temë për të cilën nuk është kompetente komuna, ose për zgjidhjen e cila nuk është e realizueshme për shkak të disa pengesave të cilat forumi nuk mund t'i parashikojë. Prandaj, prezenca e përfaqësuesve nga të gjitha sektorët është kyçe për diskutim kualitativ dhe efektiv.

Për shembull komuna në komunën e Prilepit qytetarët ofruan zgjidhje për renovimin e përmendores së kulturës, për të cilën kompetent ishte Instituti për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Përfaqësues të komunës së Prilepit dhe të Institutit ishin prezent në Forum dhe ua sqaruan qytetarëve procedurën për intervenimet e këtilla.

Në forumin projektues, tematik dhe ndërkomunal kryetari më së shpeshti merr pjesë në sesionin e parë, të pestë dhe të fundit. Në sesionin e parë ai/ajo është prezent që t'i përshëndesë qytetarët, t'i elaborojë nevo-

jat për forumin dhe t'i inkurajojë qytetarët të marrin pjesë. Në sesionin e fundit gjithashtu ai/ajo duhet t'i përshëndesë qytetarët dhe t'u dëshirojë zgjedhje të suksesshme të vendimit, si dhe t'i pranojë nga pjesëmarrësit rekomandimet nga forumi. Në sesionin e fundit ai/ajo është prezent që të tregojë se si janë realizuar vendimet/projektet e votuara nga qytetarët.

Në forumin buxhetor, kryetari i komunës merr pjesë në të gjitha sesionet forumore, pasi që kryetari i komunës është propozues i buxhetit dhe mbrojtës i tij para Këshillit komunal dhe para qytetarëve.

Këshilltarët nga komuna mund të zgjedhin se si do të marrin pjesë në forum:

- përmes formimit të tryezës së tyre të punës,
- me uljen në cilëndo tryezë pune në pajtim me interesin personal apo
- Do të ulen në tryezën e punës së bashku me administratën komunale.

Për shembull në forumin e komunës së Prilepit dhe të forumit ndërkomunal në Mogillë dhe Novaci këshilltarët komunal formuan tryezë të veçantë pune.

Pjesëmarrja e këshilltarëve është me rëndësi të jashtëzakonshme, pasi që ata në Këshillin komunal i përfaqësojnë qytetarët, prandaj forumi mund të jetë vend i shkëlqyer ku sipas informacioneve të dorës së parë do të njoftohen me prioritetet e qytetarëve dhe do të mund të njëjtat t'i përfaqësojnë në seancat e Këshillit.

P.sh. në Forumin e komunës së Çairit disa nga këshilltarët në Këshillin e komunës rrinin në tryezën e punës të administratës komunale. Në forumin në komunën e Dibrës njëri nga këshilltarët në Këshillin e komunës qëndronte në tryezë për arsim të mesëm, duke konsideruar se atje më së miri do ta japë kontributin e tij.



Ata mund të zgjedhin dhe të mos marrin pjesë në forum përmes tryezës së punës, por të jenë pjesë e publikut.

Mediet, gjithashtu, mund të formojnë edhe tryezë të tyre, nga e cila do ta japin perspektivën e tyre për temën, jashtë njoftimit profesional.

Sipas përvojave të arritura në programin “Forume në bashkësi” erdhëm deri tek njohuritë se në Maqedoni më optimale është që diskutimet forumore të zhvillohen në jo më pak se 6 sesione nga të cilat special të zgjasë jo më shumë se 3 orë, ndërsa të gjitha sesionet të zhvillohen në periudhë prej 4 deri 5 muaj.

Në forumet buxhetore për shkak kornizës ligjore lidhur me procesin e përgatitjes së buxhetit, sesionet forumore zhvillohen në afat prej 3-4 muajve, gjegjësisht në periudhën kur komuna ka për obligim të përgatisë buxhetin (shtator-dhjetor).

## KREU 4

# 10 HAPA PËR ZBATIMIN E FORUMEVE NË BASHKËSI

## HAPI 1

### Vendimi për forumin në bashkësi / Identifikimi i nevojës për forum

#### A) Iniciatori i forumit

Kryetari dhe Këshilli i Njësitit të vetëqeverisjes lokale me iniciativë të vetën organizojnë forume të bashkësisë, si formë e pjesëmarrjes publike të të gjithë qytetarëve në njësitin e vetëqeverisjes lokale, për shkak debatit publik për problemet dhe përcaktimin e zgjidhjeve dhe prioritetëve, propozimin dhe zgjedhjen apo zhvillimin e projekteve me interes për bashkësinë.

Organizimi i forumeve mund të ngritet edhe me iniciativë të personave të interesuar juridik dhe fizik (OJQ, institucione publike etj.) të cilat janë të gatshëm financiarisht dhe materialisht ta mbështesin projekte në interes të njësisë së vetëqeverisjes lokale. Këta persona parashtrajnë kërkesa deri tek kryetari i njësisë së vetëqeverisjes lokale, i cili në bazë të dokumenteve strategjike dhe qëllimeve për zhvillimin e njësisë së vetëqeverisjes lokale vendos nëse iniciativa do të pranohet ose refuzohet. Iniciatori i forumit ka për detyrë në fillim të kontaktojë me palët e involuara dhe të llobojë për pjesëmarrjen e tyre në forum. Pas sjelljes së vendimit iniciatori i forumit më nuk do të veprojë vetëm, por së shpejti do të involvohen edhe persona të tjerë, Procesi drejt fillimit të forumit atëherë do t'i bartet koordinatori, moderatorit dhe personave të tjerë kyç. Iniciatori do të mbetet aktiv si promovues i forumit, i cili i jep mbështetje procesit dhe i cili ka rol ndikues. Sapo të fillojë me punë “makineria” e forumit, iniciatori mund ta ketë rolin e padronit të procesit dhe të rezultateve, por pa përzierjen dhe pa harruar se forumin e lëvizin pjesëmarrësit.



## B) Tema e forumit

Temat dhe llojet e forumeve bazohen sipas nevojës së komunës, ndërsa qëllimi është të diskutohet temë, problem apo çështje e cila është aktuale, e rëndësishme, në mënyrë të drejtpërdrejtë i prek qytetarët në jetën e përditshme dhe zgjidhja e së cilave do ta përmirësonte jetën e qytetarëve. Është e rëndësishme temat të jenë në kuadër të kompetencave të komunës që të mundet vendimet e sjella, zgjidhjet dhe projektet nga forumi të realizohen.

Temat e forumit të bashkësisë duhet t'i plotësojnë edhe kriteret në vazhdim:

- Temat të jenë me rëndësi për të gjithë bashkësinë, duke i përfshirë të gjitha bashkësitë etnike si dhe anëtarë femra dhe meshkuj të bashkësisë;
- Për secilën nga temat e propozuara të ekzistojnë dhe të theksohen probleme konkrete të cilat mund të zgjidhen në nivel lokal;
- Temat të nxisin mendime të ndryshme për zgjidhjen e tyre;
- Temat të zgjidhen përmes procesit participues (anketa, debate publike paraprake, diskutime etj.).

Temat mund, për shembull, të jenë: "infrastruktura lokale", "gjendja me objektet sportive në komunë", "zhvillimi ekonomik lokal", "arsimimi", "zhvillimi urban", "mbrojtja e mjedisit jetësor", "furnizimi me ujë" etj

Nëse ndonjë çështje është e vëllimit më të gjerë, mund të kërkojë edhe kyçjen e qytetarëve nga një ose dy komuna fqinje në zgjidhjen e tyre. Tema duhet të jetë e rëndësishme për të gjitha komunat e kyçura, ndërsa zgjidhja e problemeve të cilat dalin nga tema të kërkojë bashkëpunim ndërkomunal.

Tema të këtitilla më së shpeshti janë "grumbullimi i mbeturinave", "furnizimi i me ujë dhe ujërat e ndotur", "planifikimi urban", "turizmi" etj.

Forumit, gjegjësisht qytetarëve, u ofrohen 2-3 tema të rëndësishme nga të cilat në sesionin e parë të forumit qytetarët do ta përcaktojnë interesin e tyre për njërin nga temat, ndërsa më pas, në sesionet e ardh-

shme, më thellë do t'i qasen asaj, duke përcaktuar probleme konkrete dhe duke propozuar zgjidhje konkrete.

Në forumin tematik ofrohet temë e cila është aktuale dhe për të cilën ekzistojnë 2 pikëpamje(palë) të ndryshme për atë se si të zgjidhet.

Si shembull për një temë të këtitillë është: "Nëse duhet hapur qendër për përkujdesjen e personave të cilët keqpërdorin drogë në komunë dhe ku?"

Tema e forumit buxhetor definohet prej më parë – përgatitja e buxhetit komunal për vitin e ardhshëm.

Zakonisht Këshilli komunal dhe administrata kyçen në zgjedhjen e temës së forumit. Shpesh herë tema del nga prioritetet aktuale të komunës – nga planet zhvilluese, plani strategjik i komunës, plani për zhvillim lokal ekonomik apo debati vijues në Këshillin komunal. Temë e mirë e forumit është ajo e cila është e rëndësishme për jetën e përditshme të qytetarëve – e cila është lëndë e diskutimit në mediet, kafenetë, shtëpitë, para se të hyjë në sallën e forumit.



## HAPI 2

### Mjetet për organizimin e forumit

Procesi i forumit sipas rregullit financohet nga ana e Njësitit të vetëqeverisjes lokale. Njësitit i vetëqeverisjes lokale duhet në Buxhetin e tij të parashohë mjete të mjaftueshme për aktivitetet e këtylla të cilat bien në kategorinë e pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve në vendimmarrjen e komunës.

Mjetet të cilat komuna duhet t'i sigurojë duhet t'i mbulojnë këto shpenzime:

- » Honorarin për moderatorin,
- » Honorarin për bashkëmoderatorin,
- » kompensim për anëtarët e grupit operativ. Këto mjete janë minimale dhe shërbejnë për mbulimin e shpenzimeve të anëtarëve të grupit operativ të cilat i kanë ata gjatë angazhimit të tyre në forum, si p.sh., për transport, për telefon celular etj.
- » Kompensim për sallën në të cilën do të mbahet forumi
- » Kompensim për pajisjen teknike, gjegjësisht teknikën e zëritit të sallës
- » Mjete për shtypjen e Buletinit të forumit.
- » Kompensim për përkthyesin. Në komunat në të cilat përveç gjuhës maqedonase përdoren edhe gjuhë të tjera si zyrtare, është e nevojshme të sigurohet mundësia secili të shprehet në gjuhën e tij dhe prandaj në sesionet e forumeve është e nevojshme të ketë përkthyes të cilët do të bëjnë përkthimin konsekuativ gjatë sesionit.
- » Honorar për ekspertët. Nëse janë të nevojshëm persona të cilët do ta japin mendimin e tyre profesional për ndonjë çështje të iniciuar nga forumi, atëherë ata duhet të angazhohen dhe të paguhen.
- » Shpenzime për transport. Nëse në komunën në të cilën zbatohet forumi nuk ekziston transport publik, ndërsa vendet e banuar janë larg nga vendi i mbajtjes së forumit, komuna duhet të sigurojë transportin e pjesëmarrësve nga venet më të largëta.

Për shembull, në komunën Çashkë, Karbinci, Mogilla dhe Dollneni në të cilat vendet e banuara janë shumë larg qendrës komunale në të cilin mbahet forum, komuna i shfrytëzon transportuesit me të cilët ka lidhur marrëveshje për transportimin e nxënësve të sigurojë transport dhe prezencë të qytetarëve të interesuar për pjesëmarrje në forum.

- » Fondi projektues, gjegjësisht mjetet për realizimin e ideve të qytetarëve të votuara në sesionin e pestë forumor;
- » Kompensim për përgatitjen e dokumentimit teknik. Në forumin projektues, ndërkomunal, ndërsa ndonjëherë edhe në forumin tematik të cilat rezultojnë me projekte të infrastrukturës, komuna duhet të sigurojë edhe mjete për përgatitjen e dokumentimit teknik për intervenimet ndërtimore.

Procesi i forumit mund të financohet edhe nga personat e interesuar fizik dhe juridik të cilët janë të gatshëm të jenë donatorë të njësitit të vetëqeverisjes lokale.

Projektet të cilat do të dalin nga procesi forumor mund të realizohen edhe në partneritet me organizata dhe institucione të tjera. Më pas pjesëmarrja e partnerëve mund të jetë financiar apo në natura. Përmes kycjes së partnerëve kontribuohet nga sukcesi më i madh i projektit.

## HAPI 3

### Formimi i ekipit për zbatimin e forumit

Ekipi për zbatimin e forumit luan rol kyç për suksesin e forumit dhe prandaj duhet t'i kushtohet vëmendje zgjedhjes së personave të cilët e përbëjnë. Këta persona do të obligohen me detyra operative lidhur me realizimin e forumit, siç janë mobilizimi i prezencës në forum, organizimi dhe mbajtja e sesioneve forumore, fascilitimi i diskutimeve, organizimi i takimeve midis sesioneve të forumeve, sigurimi i transparencës



dhe dukshmërisë së forumit dhe të rezultateve të forumit, si dhe të gjitha obligimet e tjera të cilat dalin nga ai. Kyç për suksesin e punës së ekipit të për zbatimin e forumit është komunikimi i mirë midis të gjithë anëtarëve të tij. Forumin e organizon dhe e udhëheq moderatori (person i jashtëm i certifikuar) me mbështetjen e komoderatorit lokal. Ata në bashkëpunim me njësitin për vetëqeverisje lokale formojnë grup operativ lokal, të përbërë nga koordinatori/ët nga komuna, përfaqësues i medie dhe përfaqësues nga palët e involvuara kyçe (OJQ, biznes sektori, arsimit, bujqësia etj.). Pritet se të gjithë anëtarët e ekipit do të marrin pjesë rregullisht në të gjitha takimet e caktuara nga ana e moderatorit dhe bashkëmoderatorit. Ndërsa ndonëse dikush mungon me arsye, do të informohet nga të tjerët për atë se çka ka ndodhur në takim dhe cilat janë obligimet e tij/të saj të ardhshme. Njëkohësisht të gjithë këta persona duhet midis tyre të koordinohen në kryerjen e detyrave, pa mbivendosje. Proceset, si forumi të cilat përfshijnë një numër të madh të njerëzve me shumë nevoja të ndryshme, ide dhe veçori karakteristike, mund të jenë shumë të lodhshme dhe prandaj të gjithë anëtarët e ekipit për zbatimin e forumit duhet të sillen me durim, mirëkuptim, tolerancë dhe transparencë për bashkëpunim në komunikimin midis tyre dhe me pjesëmarrësit në forum.

### A) Zgjedhja e koordinatorit të komunës/donatorit

Kryetari i komunës e cila e zbaton forumin duhet të zgjedh një person si koordinatör të procesit të forumeve. Ky person do të jetë përgjegjës për kontaktet me administratën komunale, këshillin dhe kryetarin nga njëra anë dhe anëtarët e tjerë të grupit operativ, moderatorit dhe bashkëmoderatorit, personin për marrëdhënie me publikun, pjesëmarrësit në forum, dhe nëse ekziston, donatorin e mjeteve për forumin. Koordinatorit obligohet për koordinimin gjithëpërfshirës dhe komunikimin midis të involvuarve dhe njëkohësisht është anëtar i grupit operativ të Forumit.

Nëse bëhet fjalë për donator, ai nënkupton një person i cili komunikon me koordinatorin e komunës dhe mban llogari që gjithçka të zhvillohet sipas marrëveshjes/planit.

### B) Zgjedhja e moderatorit

Punën e forumit e udhëheq moderatori, të cilin e zgjedh organizatori i forumit në bazë të thirrjes publike, si person neutral i cili i takon bashkësisë lokale (nuk është banor i njësitit të vetëqeverisjes lokale). Moderatorin luan rol kyç në procesin e forumit. Ai/ajo e udhëheq procesin e forumit në komunën përkatëse, gjegjësisht i organizon dhe moderon sesionet e forumit dhe punën midis sesioneve me mbështetjen nga bashkëmoderatori lokal dhe në koordinim me grupin operativ. Gjatë forumit moderatori i orienton diskutime nga temat, problemet, zgjidhjet, konceptet e ndryshme dhe projektet dhe e udhëheq procesin e votimit dhe zgjedhjes së zgjidhjeve, gjegjësisht projekteve.

Moderatori në mënyrë gjithëpërfshirëse udhëheq me forumin, duke e përfshirë koordinimin e punës së bashkëmoderatorit, grupit operativ dhe të grupeve të punës. Ai/ajo e udhëheq procesin e fillimit dhe vendosjes së forumit, merr pjesë në zgjedhjen dhe në emërimin e bashkëmoderatorit dhe të anëtarëve të grupit operativ. Gjatë përgatitjes së sesioneve moderatorin mundet, me ndihmën e grupit operativ, të mbajë edhe "takime motivuese" individuale me pjesëmarrësit kyç dhe me ekspertët e jashtëm. Nëse është e nevojshme moderatori mundet të marrë pjesë në promovimin medial të forumit përmes dhënies së deklaratave apo intervistave për mediet lokale. Moderatorin obligohet të dorëzojë raporte me shkrim deri tek koordinatori i komunës pas çdo sesioni të kaluar forumor në të cilën do të njoftojë për rrjedhën e sesionit, rezultatet nga ajo dhe planet për sesionin e ardhshëm.



Moderatori nuk është vetëm menaxher. Ai/ajo e udhëheq komunikimin me autoritetet komunale dhe me palët e involvuara, përfshirë edhe takimet personale me pjesëmarrësit kyç të forumit.

Pikërisht për shkak vëllimit të madh të detyrave dhe obligimeve lidhur me forumin, moderatori duhet të jetë person i cili ka përvojë paraprake në mbajtjen e forumeve të bashkësisë. BNJVL do të certifikojë moderatorë të cilët kanë marrë pjesë në tre fazat paraprake të programit “Forume në bashkësi” dhe komunat do të mund të zgjedhin moderatorë të cilët kanë përvojë. Preferohet moderatori të ketë njohuri të mira për temën e cila do të diskutohet në forumin, veçanërisht për forumet buxhetore. Për mbajtjen apo udhëheqjen e forumeve buxhetore moderatori duhet të ketë aftësi të mediacionit (përshkrimi i thukët i detyrave të punës së moderatorit është dhënë në Aneksin 1)

### C) Zgjedhja e bashkëmoderatorit

Forumit ka bashkëmoderatorin i cili zgjidhet nga ana e moderatorit të forumit në konsultime me organizatorin e forumit, e gjithashtu përmes thirrjes publike (shembulli për thirrjen publike është paraqitur në Aneksin2). Ai/ajo i jep mbështetje punës së moderatorit në udhëheqjen me grupin operativ dhe me grupet e punës dhe është “dorë e djathtë” e tij/saj. Bashkëmoderatori është person i cili vjen nga bashkësia, gjegjësisht nga komuna, por nuk është i punësuar në NJVL, e as nuk është anëtar i Këshillit. Ky person duhet të gëzojë respekt në bashkësi që të mund t’i motivojë qytetarët të marrin pjesë në sesionet forumore dhe t’i koordinojë anëtarët e grupit operativ në grumbullimin e informacioneve të domosdoshme për punën e Forumit. Ai/ajo duhet ta lehtësojë bartjen e informacioneve deri tek palët e ndryshme të involvuara (i bart informacionet nga moderatorin deri tek komuna, grupi operativ, grupet punuese dhe deri tek opinionin më i gjerë dhe anasjelltas). Prandaj ai/ajo duhet të jetë banor i komunës në të cilën mbahet forumi dhe të ketë përvojë në paraqitjen publike para një auditoriumi më të madh dhe të mos ketë konflikt interesash me projektet e zhvilluara në forumet. Bashkëmoderatori duhet të ketë përvojë në fasilitim dhe koordinim dhe aftësi të shkëlqyera komunikuese, njohje të mirë të temës së forumit, si dhe marrëdhënie të mira me administratën e komunës, mediet lokale



dhe institucionet (përshkrimi i detyrave të punës së bashkëmoderatorit është dhënë në Aneksin 3)

Roli i tij/saj kryesor është mbështetja e moderatorit gjatë kohës së sesionit forumor. Megjithatë, po aq i rëndësishëm është roli midis sesioneve kur bashkëmoderatori i organizon dhe bashkëmoderon takimet e grupeve punuese dhe mban evidencë për përpunimin dhe distribuimin e procesverbaleve të rregullta të sesioneve në kohë, përgatitjen e rezumeve dhe dokumenteve të tjera deri tek moderatorin, anëtarët e grupit operativ, grupet e punës dhe deri tek opinionin më i gjerë.

Së bashku me grupin operativ, bashkëmoderatori i organizon sesionet e forumeve – e organizon hapësirën për mbajtjen e sesioneve forumore, pajisjen për punë, audio pajisjen, freskimin dhe mbështetjen tjetër logjistike me kërkesë të moderatorit dhe organizatorit të forumit, duke e përfshirë edhe rekrutimin e pjesëmarrësve për Forumin.

### Ç) Zgjedhja e anëtarëve të grupit operativ

Për mbështetjen e plotë tekniko-profesionale të forumit formohet grupi operativ (GO).

Grupi operativ i cili punon nën udhëheqësin e moderatorit dhe bashkëmoderatorit është trup operativ, e jo trup udhëheqës. Që të shmangët konflikti i interesave, anëtarët e GO-së, zakonisht, nuk marrin pjesëmarrje aktive në diskutimet e forumeve dhe personalisht nuk paraqiten për zbatimin e projekteve të dala nga Forumi.

GO, të cilin e udhëheq moderatori, më së shpeshti e përbëjnë 6-7 persona, të cilët i paraqesin palët e involvuara apo të prekura kyçe në bashkësi, ata janë:

- bashkëmoderatori
- 2 përfaqësues nga komuna, nga të cilët njëri është koordinatori i komunës
- 1 përfaqësues i medie dhe njëherit person për marrëdhënie me publikun e forumit
- 3 përfaqësues nga palët e involvuara kyçe (OJQ, biznes sektori, arsimiti, bujqësia etj.).



Tek forumet buxhetore në GO duhet të jenë edhe së paku dy persona si përfaqësues nga shfrytëzuesit buxhetor në komunë – shkollë, ndërmarrje publike, shtëpi kulture etj.

Njëri nga anëtarët e grupit operativ do të obligohet të mbajë proces-verbal nga sesionet dhe takimet e grupeve punuese.

Anëtarët e grupit operativ janë qytetarë prestigjiozë të cilët vijnë nga sferat e ndryshme nga jeta shoqërore në bashkësi dhe të cilët mund të ndihmojnë në motivimin e qytetarëve që të marrin pjesë në forum.

Detyra kryesore e anëtarëve të grupit operativ është organizimi i sesioneve forumore dhe takimeve punuese midis sesioneve. Ata marrin pjesë në punën e grupeve të punës dhe u ndihmojnë në punë (përshkrimi i detyrave të punës të anëtarëve të GO-së është dhënë në Aneksin 4).

### D) Zgjedhja e personit për marrëdhënie me publikun

Personi për marrëdhënie me publikun e forumit ka rol kyç në përhapjen e informacioneve gjatë gjithë forumit dhe gjegjësisht e siguron edhe transparencën e procesit. Ai/ajo mund të jetë gazetar i punësuar në medium lokal, ose, të jetë person zyrtar për marrëdhënie me publikun e vetë komunës. Ky person ka për detyrë t'i njoftojë qytetarët për atë se në komunën e tyre po zhvillohet forum dhe për këtë qëllim duhet të jetë i përgjegjshëm për përgatitjen e fletushkave dhe posterëve. Ai/ajo duhet t'i ftojë mediet (para së gjithash ato lokale, veçanërisht për forumet në komunat të cilat nuk janë në Shkup) të sesioneve forumore dhe të njoftojë nga, gjegjësisht pas forumit (shembull për ftesën e medie është dhënë në Aneksin 5). Ai/ajo duhet të sigurojë promovim të rregullt media dhe kualitativ të forumit përmes organizimit të paraqitjes në media të kryetarit të komunës, donatorit (nëse forumi nuk financohet vetëm nga komuna por nëse ka edhe donator), moderatorit etj. Për gjithë këtë, personi për marrëdhënie me publikun mban evidencën e aktiviteteve mediale dhe press-clipping nga forumi të cilat janë në dispozicion të organizatorit të forumit. (formati për evidentimin e aktiviteteve mediale është dhënë në Aneksin 6).

Qytetarët të cilët nuk marrin pjesë në forum, për punën e forumit njoftohen nga buletini i forumit. Personi për marrëdhënie me publikun është përgjegjës për përgatitjen e buletinit dhe në bashkëpunim me moderatorin dhe GO duhet t'i sigurojë materialet nga forumi. (fotografi, deklarata, tekste etj.).

Të gjitha informacionet para dhe pas forumit ia dërgon personit kompetent të NJVL i cili është kompetent për ueb faqen e komunës, me qëllim që këto informacione të kenë qasje për qytetarët edhe përmes këtij kanali të komunikimit.

Nëse është i punësuar në komunë, personi për marrëdhënie me publikun e azhuron ueb faqen komunale me informacione lidhur me forumin.

Që të jetë në rrjedhë me ngjarjet e forumit, personi për marrëdhënie me opinionin merr pjesë në të gjitha sesionet e forumeve, në të gjitha takimet e grupit operativ dhe në të gjitha ngjarjet lidhur me forumin. (përshkrimi i detyrave të punës së personit për marrëdhënie me publikun është dhënë në Aneksin 7).

## HAPI 4

### Mobilizimi i bashkësisë

#### A) Kush është kompetent për mobilizimin e qytetarëve? Si?

Mobilizimi i bashkësisë është kyç për suksesin e forumit.

Anëtarët e grupit operativ e kanë detyrën kryesore për mobilizimin e qytetarëve, së bashku me personin për marrëdhënie me publikun, si dhe me kryetarin e komunës i cili duhet me lidhshmëri të tij t'i bind qytetarët të marrin pjesë në forum.

Sa më i madh të jetë numri i pjesëmarrësve në forum, aq më legjitime janë vendimet/zgjidhjet të cilat ai i ka sjellë, ndërsa të cilat më pas i zbaton vetëqeverisja lokale. Pasi që nuk është e mundur, e as e nevojshme në forum të marrin pjesë të gjithë qytetarët, preferohet të gjitha grupet në bashkësi të përfaqësohen me disa përfaqësues të tyre. Përfaqësuesit e këtyre grupeve do t'i "mbrojnë" interesat e grupit të vet dhe do të mundësojnë që edhe zëri i tyre të dëgjohet. Prandaj, komuna duhet të insistojë për prezencën e sa më shumë qytetarëve nga profilet dhe lokacionet e ndryshme në komunë. Me këtë do të shmangen kritikën për uzurpimin apo politizimin e procesit. Mënyra e vetme që të realizohet kjo është të njoftohen qytetarët për forumin, ndërsa ata vetë të vendosin nëse do të marrin apo nuk do të marrin pjesë.



#### • Informimi i publikut (posterë, fletushka, aktivitete mediale dhe promovuese, buletinë)

Bashkëpunimi me mediet lokale dhe kombëtare është mjaft i rëndësishëm për procesin forumor, pasi që vetë në këtë mënyrë mund të arrihet shkallë më e lartë e masivitetit dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në proces. Pjesëmarrja e medieve gjatë prezantimit të procesit duhet të jetë firmues, për të cilën gjë më së shumti është përgjegjës personi për marrëdhënie me publikun në nivel lokal, me mbështetje aktive të komunës.

Mënyra më e zakonshme e informimit të qytetarëve është përmes përpunimit dhe vendosjes së posterëve në vendet më frekuentuese në komunë me të cilat qytetarët thirren të marrin pjesë në sesionin forumor. Te posterët duhet të qëndrojnë vendi dhe koha e mbajtjes së forumit dhe qëllimi i së njëjtit (shembull për poster është dhënë në Aneksin 8) Posterët vendosen në vende publike, siç janë tabelat komunale për shpallje, vendi ku mbahet forumi, shitoret lokale, shkollat, bashkësitë lokale dhe vende të tjera publike nëpër të cilat lejohet ngjitja e pllakatëve.



Njëkohësisht mund të përpunohen edhe fletushka në të cilat shkurtimisht do të sqarohet qëllimi i forumit, temat, rrjedhja e procesit, koha dhe vendi i mbajtjes dhe kontaktet për paraqitjen e pjesëmarrjes (shembull për fletushkat është dhënë në Aneksin 9a dhe 9b). Qytetarët mund, por edhe nuk është e domosdoshme të paraqiten për në forum para se të marrin pjesë në sesionin e parë forumor.

Buletinet (shembulli për buletin është dhënë në Aneksin 10a dhe 10b) shërbejnë për informimin rreth asaj se çka po ndodh në forum.

Ato i përgatit personi për marrëdhënie me publikun e forumit, me mbështetjen e moderatorit dhe GO-së, ndërsa u shpërndahen pjesëmarrësve të forumit dhe qytetarëve të komunës (nëpërmjet posta, banka, markete, komunë etj.) Forumi boton 3 numra nga buletini. Numri i parë i buletinit i **forumit projektues, tematik dhe ndërkomunal**, botohet pas sesionit të dytë forumor dhe përmes fotografive, deklaratave të pjesëmarrësve, intervistave dhe tekstit i mbulon ngjarjet nga dy forumet e para. Numri i dytë del pas sesionit të pestë forumor dhe në të janë paraqitur projektet, zgjidhjet, propozimet e forumit në lidhje me temën e forumit. Numri i tretë botohet pas sesionit (të fundit) të gjashtë dhe në të paraqiten zgjidhjet dhe projektet e realizuara. Nëse komuna boton lajmëtarin e vet, informacionet për Forumin mund të vendosen në të ose të shkojnë si shtesë.

Edhe forumi buxhetor boton tre numra të buletineve. Numri i parë përmban informacione për kalendarin buxhetor dhe konceptet themelore nga buxhetet e komunës, numri i dytë publikon përmbajtje për atë se çka është punuar në sesionin e parë, info-propozime për përmirësimin e të ardhurave, propozim-shpenzime sipas kompetencës, si dhe intervistë/deklaratë e kryetarit të komunës dhe qytetarëve, ndërsa numri i tretë i përmban projektet e realizuara si dhe numrin e pro-

pozimeve të kyçura të qytetarëve në buxhetin e komunës.

Procesverbalet e sesioneve të forumeve gjithashtu shërbejnë si vegël për informimin e qytetarëve për atë se çka ka ndodhur në forum. Ato përgatiten pas secilit sesion, vendosen në ueb-faqen e komunës dhe distribuohen në sesionin e ardhshëm.

Para se të mbahet forumi, preferohet kryetari i komunës të dalë para medieve lokale elektronike dhe/apo të shtypit dhe ta paralajmërojë forumin, duke e sqaruar qëllimin e tij dhe mënyrën e punës. Më pas mund të pasojnë paralajmërime në mediat lokale si ftesë që qytetarët të marrin pjesë në forumin me datën, vendin dhe kohën e paralajmëruar. Qëllimi është të njoftohet e gjithë bashkësia se do të ketë forum pavarësisht asaj se disa qytetarë do të vendosin të mos marrin pjesë. Një pjesë e tyre rregullisht do t'i ndjekin informacionet për punën e forumit.

Mediet duhet t' shërbejnë procesit të forumit të sigurojë shikueshmëri dhe në mënyrë aktive të marrin pjesë në krijimin dhe promovimin e mënyrës demokratike të vendosjes përmes Forumeve.

#### • Ftesa të drejtpërdrejta

Ftesat e drejtpërdrejta deri tek qytetarët nuk duhet të anashkalojnë dhe janë treguar si më efektive në sigurimin e pjesëmarrësve në forum. Ftesat dërgohen në mënyrë të drejtpërdrejtë, në formë të shkruar, deri tek personat kyç në bashkësi, veçanërisht deri tek ata të cilët involvohen në mënyrë më të drejtpërdrejtë nga temat e forumit. Ato mund të dërgohen deri tek: kryetarët e bashkësive urbane dhe lokale, drejtorët e shkollave, ndërmarrjet publike, përfaqësues të shquar të sektorit afarist, kryetarët e OJQ-ve, klubet sportive, mediet, shoqatat profesionale etj. Ftesat nënshkruhen nga kryetari i komunës dhe së bashku me ftesat dërgohet edhe informacion i shkurtër – sqarim për atë se çfarë është forumi.

#### • Thirrje telefonike, postë elektronike etj..

Pas sesionit të parë të forumit (në të cilin qytetarët nënshkruhen në listën e pjesëmarrësve), me dërgimin e informacioneve përmes postës elektronike me vendosjen e paralajmërimit dhe ftesës për ngjarjen në ueb faqen e komunës dhe me metodën "nga veshi në vesh", gjegjësisht me përhapjen e informacioneve përmes miqve dhe të njohurve.



#### • Takime me qytetarët

Iniciatori i forumit, nëse vlerësohet se është e nevojshme, mund të realizojë edhe takime të drejtpërdrejta me qytetarët për së afërmi ta sqarojë qëllimin e forumit dhe mënyrën e punës së forumit, si dhe përfitimet për qytetarët nga pjesëmarrja në të njëjtin. Praktika e deritanishme e zbatimit të forumeve tregon se këto takime sjellin rezultate të konsiderueshme. Organizohen me të ashtuquajturit liderë lokalë persona të njohur dhe të pranuar në bashkësi, të cilët mund të animojnë një numër të konsiderueshëm të pjesëmarrësve në forum. Në këto takime komuna duhet ta sqarojë nevojën e forumit, por edhe dobinë që secili individ/grup do ta kishte nga pjesëmarrja në të njëjtin.

#### • Fokus grupe / takime me palë të prekura (involvuara)

Me qëllim që të sigurohet llojllojshmëri e prezencës në forum, iniciatori i forumit mund të organizojë edhe fokus grupe gjegjësisht takime me grupe të caktuara të qytetarëve për të cilët ekziston mundësia të mos marrin pjesë në forum. Për shembull, shpesh herë në mjediset të cilat janë më tradicionale, gratë nuk marrin pjesë në forum. Kur të merret parasysh se ato më së shpeshti përbëjnë 50% të popullatës në një bashkësi të caktuar, mirë është të organizohen takime të veçanta vetëm me to (përmes OJQ-ve për gra, shoqatave bujqësore të grave etj) në të cilat do të sqarohet qëllimi dhe mënyra e punës së forumeve si dhe përfitimet për to, nëse vendosin të marrin pjesë. Për vëmendje më të madhe, mirë është në këtë takim apo takime të jenë prezent dhe të flasnin jo vetëm përfaqësuesit e komunës, moderatori dhe bashkëmoderatori por edhe personalitete të cilët kanë ndikim tek këto target grupe. E njëjta mund të zbatohet edhe për sigurimin e prezencës së të rinjve në forum, përfaqësuesve në sektorin afarist të cilët shpesh herë janë shumë të zënë për iniciativatë të këtilla, si dhe përfaqësuesit nga bashkësitë e ndryshme etnike. Në asnjë moment nuk duhet harruar se të pranishmit në Forum duhet ta pasqyrojnë bashkësinë, nëse ka 50% të grave në komunë, përfaqësuesit për qindje të njëjtë duhet të ketë edhe në Forum.

## HAPI 5

### Organizimi i sesionit të parë të forumit

Forum i zhvillohet në 6 sesione. Në sesionin e parë forumor prezantohet procesi forumor, dhe zgjidhet tema e forumit, formohet struktura e forumit dhe përcaktohen parimet për punë (shih Aneksi 11, 12, 13 dhe 14 për Rendin e ditës për sesionin e parë forumor për llojet e ndryshme të forumit)

Sesioni i parë është kyç për procesin e mëtutjeshëm forumor, pasi që qytetarëve duhet t'ju prezantohet qëllimi dhe rëndësia e procesit forumor, si dhe dobia të cilën do ta kenë nëse marrin pjesë në të njëjtin dhe mënyra e konvokimit të sesionit të parë është përcaktuar në nenin 12 të Rregullores. Sesioni i parë duhet ta tërheqë interesin e qytetarëve dhe t'i motivojë që të jenë pjesëmarrës aktiv në sjelljen e vendimeve, të rëndësishme për jetën e tyre dhe për bashkësinë. Në pajtim me këtë, ky sesion fillon me prezantimin e forumit, qëllimeve dhe specifikaciteteve të së njëjtit, si dhe me sqarimin e roleve të të gjitha palëve të involvuara. Gjatë këtij prezantimi rekomandohet të shfrytëzohen praktikatat dhe shembujt nga komunat të cilat e kanë kaluar këtë proces dhe të cilat kanë arritur rezultate konkrete. Në fillim të sesionit fjalën e merr organizatori i forumit (më së shpeshti kryetari i komunës). Më pas pason prezantimi i cili e sqaron procesin e organizimit dhe funksionimit të forumit.



Pas prezantimi të procesit të forumit, pason zgjedhja e temës së forumit e cila paraqet edhe vendimin e parë të përbashkët të sjellë nga ana e qytetarëve në forum. Varësisht nga ajo se çfarë lloji i forumit po zbatohet, (projektues, tematik, ndërkomunal apo buxhetor), ekziston proces i veçantë i zgjedhjes, propozohen tema të cilat janë aktuale dhe të rëndësishme për qytetarët dhe janë pjesë e planeve strategjike të komunës, gjegjësisht janë nën kompetencat e saj. Propozuesi i temës, komuna, u sqaron pjesëmarrësve se pse janë propozuar temat dhe jep sqarim të shkurtër për secilën nga temat e propozuara. Zgjedhja e temave është vendimi i vetëm i forumit i cili silltet me shumicë votash. Shkaku është se tryezat e punës akoma nuk janë formuar, më tej vendimet i sjellin pjesëmarrësit përmes tryezave të punës. Çdo pjesëmarrës voton për temën për të cilën e konsideron si prioritare dhe pas numërimit konstatohet se cila temë do të zhvillohet gjatë gjithë procesit të forumit. Tema e cila do të ketë më së shumti vota nga qytetarët shpallet si temë e forumit e cila do të përpunohet deri në fund të procesit të forumit.

I ngjashëm është procesi i zgjedhjes së temës edhe në **forumin ndërkomunal**, me atë që temat e propozuara duhet të jenë të interesit dhe rëndësishme së përbashkët për të gjitha komunat e përfshira, ndërsa zgjidhja e problemeve të cilat dalin nga tema e zgjedhur të kërkojë bashkëpunim ndërkomunal.

Në **forumin tematik** prezantohet (një) temë e cila është aktuale dhe për të cilën ekzistojnë 2 pikëpamje kryesore të kundërta (palë) për atë se si të zgjidhet.

Tema e **forumit buxhetor** definohet prej më parë – përgatitja e buxhetit komunal. Në këtë lloji të forumeve përfaqësuesi i komunës i njofton qytetarët me procesin e përgatitjes së buxhetit komunal dhe më pas e prezanton strukturën e buxhetit të komunës.

Tek zgjedhja e temës ekziston rreziku pjesëmarrësit të cilët kanë votuar për tema të cilat nuk janë zgjedhur nga shumica e qytetarëve ta braktisin forumin. Këtu është i rëndësishëm roli i moderatorit të cili duhet t'ju sqarojë pjesëmarrësve se edhe krahas asaj që tema “e tyre” nuk është zgjedhur, atë megjithatë duhet të qëndrojnë dhe ta japin kontributin e tyre si grup, dhe se si rezultat i forumit janë rekomandimet, gjegjësisht ajo që nuk është në kuadër të temës, por që është e rëndësishme për bashkësinë lokale.

Më pas pason procesi i organizimit të strukturës së forumit, gjegjësisht sistemimi i pjesëmarrësve nëpër tavolinat e punës. Qytetarët përcaktohen në cilën tavolinë pune do të ulen në pajtim me interesin e tyre, me çka formohen palë të ndryshme në pajtim me temën e forumit. Moderatorin dhe bashkëmoderatorin e udhëheqin procesin me atë që ju bëjnë thirrje qytetarëve ta shkruajnë emrin e tyre në fletët flipchart prej letre në të cilat janë shkruar emrat e tavolinave të propozuara të punës (së paku 10) dhe të cilat janë ngjitur në muret e hapësirës në të cilën mbahet forumi. Lihen edhe fletë të bardha të flipchartit për organizimin e tavolinave të punës sipas propozimit të pranishmëve në forum. Kjo bëhet pasi që është sesioni i parë dhe disa tavolina pune mund të mos formohen ose të bien në sesionin e dytë.

Është e rëndësishme të pranishmit ta dinë se tavolinat e punës duhet të jenë në funksion të temës, më pas se në tavolinën e punës nuk ulët sipas profesionit apo moshës, por se zgjidhet tavolina e punës në të cilën shprehin dëshirë më shumë të ndihmohen gjatë definimit të problemeve dhe ideve për projekte, duke menduar nga aspekti i atij target grupi. Që të formohet tavolinë pune, nevojiten së paku tre qytetarë. Nëse ka më shumë se 15 qytetarë të paraqitur për një tavolinë pune, më së miri është ajo të ndahet në dy ose në tri tavolina pune me emra të ndryshëm për punë më efikase të tavolinave të punës.

P.sh., në komunën e Novosellës më shumë se shumica e pjesëmarrësve u përcaktuan për tavolinën “bujqësi”. Me propozim të moderatorit u ndanë në: “vreshtari”, “pemëtari” dhe “bujqësi”.

Në komunën e Dibrës shumica e pjesëmarrësve u përcaktuan për tavolinën “arsim”. Me propozim të moderatorit u ndanë në “arsimi i mesëm”, “arsimi fillor” dhe “kopshtet”.

Ulja në tavolinën e punës me emërim të caktuar do të thotë se çdo grup mund ta japë perspektivën e vet për temën e diskutimit.

P.sh., nëse pjesëmarrësi rri ulur në tavolinën për mjedis jetësor, lirisht mund të marrë pjesë në secilin diskutim nga arsimi e deri te infrastruktura, ta japë mendimin e tij nga aspekti i tavolinës të cilën e përfaqëson.



Të **forumi ndërkomunal** pjesëmarrësit janë ndarë sipas tavolinave, në pajtim me interesin e tyre të përbashkët për temën e zgjedhur, e jo sipas përkatësisë komunale (p.sh., përfaqësuesit e biznes sektorit nga komunat e ndryshme ulen në tavolinën e njëjtë)

Tek **forumi buxhetor** emrat e tavolinave të punës janë përcaktuar nga shfrytëzuesit buxhetor, gjegjësisht nga kompetencat e komunës (p.sh. zhvillimi ekonomik lokal, urbanizmi, mbrojtja shëndetësore, arsimit, veprimtaritë komunale etj.) dhe qytetarët ndahen në pajtim me interesat e tyre sipas kategorive të dhëna.

Pjesëmarrja në tavolinat e punës është shumë e rëndësishme pasi që, paraqet kusht për marrjen e të drejtës së votës. Vetëm ata qytetarë të cilët ulen në tavolinat e punës, ndërsa të cilët kanë marrë pjesë në së paku 3 sesione të forumeve mund të votojnë në sesionin e pestë forumor. Të tjerët do duhet të ulen në publik.

Njëra nga vendime e para "forumike" është vendimi për parimet e punës. Vetë Forumi sjell parime për punë (si do të diskutohet, sa kohë, a do të ketë pushime etj.) dhe i miraton. Në lidhje me parimet për punë moderatorit dhe bashkëmoderatorit kanë dy mundësi, njëra është të kërkojnë grupi vetë t'i propozojë rregullat, ndërsa ata t'i shkruajnë në flipchart dhe më pas t'i përcaktojnë dhe pranojnë – çka është e pranueshme duhet të praktikohet më shumë. Mundësia tjetër është të përgatiten propozim-rregulla të cilat ju prezantohen qytetarëve t'i plotësojnë dhe miratojnë. Kjo mënyrë e zgjedhjes së rregullave

shfrytëzohet nëse njerëzit nuk janë shumë aktiv dhe nëse ekziston mundësia që të mos bëhet listë e rregullave. Parimet për punën e forumit duhet të shkruhen në fletë të madhe prej letre, e lexueshme nga larg dhe pas miratimit të tyre nga ana e të pranishmëve të ngjiten në sallë në çdo sesion që të mund t'i shohin të pranishmit dhe të mbështeten në to sipas nevojës (shembulli për parimet për punën në forum është dhënë në Aneksin 15)

Në sesionin e parë të forumit **projektues, ndërkomunal** dhe **tematik** moderatorit ua prezanton pjesëmarrësve edhe kriteret për zgjedhjen e projekteve (të paraqitura në Aneksin 16), me qëllim që te ato të realizohet pasqyrë për procesin i cili i pret.

Tek **forumi buxhetor** pas miratimit të parimeve për punë, pason prezantimi i realizimit të planit strategjik zhvillues dhe prioritetet për zhvillimin e komunës për vitin e ardhshëm dhe diskutimi për këto prioritetet. Tek Forumi buxhetor pjesëmarrësit nuk diskutojnë për zëritë për shpenzimet gjegjëse të komunës (paga, taksa komunale), por për planet zhvillimore të komunës dhe për investimet kapitale. Megjithatë buxheti duhet të prezantohet në tërësi.

Para fillimi të sesionit të parë të forumit bëhet formimi i grupit të parë të punës. Në këtë grup pune duhet të jenë përfaqësues nga të gjitha tavolinat e punës, të ketë barazi gjinore dhe të moshës. Ky grup punues do të takohet në sesionin e parë të punës dhe do të punojë në përcaktimin e gjendjes në komunës në lidhje me temën e zgjedhur. Grupi punues duhet t'i përcaktojë problemet, të bëjë hulumtim të vogël për to dhe në sesionin e ardhshëm të forumit t'i prezantojë para forumit. Formimi dhe organizimi i grupit të punës është obligim i moderatorit dhe e bashkëmoderatorit. Të gjitha informatat të cilat i nevojiten grupit punues duhet t'ju ofrohen nga ana e administratës komunale.

Është e rëndësishme të theksohet se gjatë zbatimit të forumit buxhetor duhet të ruhen qëllimet dhe parimet buxhetore.

Sesioni i parë i forumit përfundon me temën e zgjedhur, strukturën e formuar të Forumit (tavolinave të punës), parimet e miratuara për punë dhe termave të caktuar (dinamikën e caktuar) për sesionet e ardhshme.



## HAPI 6

### Organizimi i sesionit të dytë të forumit

#### FORUMI PROJEKTUES

Në **sesioni e dytë të forumit** identifikohen, definohen dhe grupohen problemet dhe zgjidhjet në kuadër të temës së përcaktuar.

Sesioni i dytë i forumit është sesion në të cilin do të fillojnë të funksionojnë tavolinat e punës. Prandaj, grupi operativ është i obliguar ta përgatisë sallën për mbajtjen e forumit. Do të vendosen aq tavolina sa janë formuar në sesionin paraprak. Tavolinat duhet të vendosen në gjysmërreth, ndërsa në çdo tavolinë do të vendoset emri i tavolinës së punës. Duhet të mbahet llogari që edhe në sesionet e tjera radhitja e tavolinave të jetë identik.

Në sesionin e dytë të forumit grupi punues i formuar në sesionin paraprak do t'i prezantojë problemet e përcaktuara në kuadër të temës së zgjedhur në sesionin e parë të forumit, gjegjësisht do të prezantohen rezultatet nga hulumtimi i tyre, me ç'rast për të njëjtat do të japin mendim edhe përfaqësuesit e vetëqeverisjes lokale edhe ekspertët lokal.

Më pas vijon procesi i definimit të problemeve dhe ideve për zgjidhjet e tyre. Çdo tavolinë pune diskuton dhe propozon 2-3 probleme të cilat më pas moderatori dhe bashkëmoderatori i grupojnë sipas ngjashmërive para forumit që të mund të shihen nga të gjithë. Pas përfundimit të shfletimit të problemeve moderatori së bashku me bashkëmoderatorin i grupon sipas ngjashmërisë dhe sipas mundësisë për zgjedhjen e së njëjtave apo zgjidhje të ngjashme. Për secilën për grupet e problemeve forumi sërish përmes tavolinave të punës ofron zgjidhje. Nëse ka shumë zgjidhje, ato mund të grupohen sipas ngjashmërisë dhe të jenë pjesë e projektit, ose të bëhet përcaktimi i prioriteteve. Thirren edhe përfaqësuesit e komunave të tregojnë nëse zgjidhjet janë në kompetencë të komunës, a janë të realizueshme dhe a bëhet fjalë për intervenim më të vogël për të cilin nuk nevojitet projekt që të mos ndodh e të zhvillohen projekte pa nevojë. Pas shqyrtimit të të gjitha zgjidhjeve pjesëmarrësit në mënyrë vullnetare, individualisht paraqiten të punojnë në zhvillimin e ndonjëris nga zgjidhjet, në pajtim me bindjen dhe mundësinë e tyre për dhënien e kontributit.



Grupet e punës duhet të kenë së paku 3 anëtarë, ndërsa numri maksimal nuk është i kufizuar. Grupet punuese në periudhën midis sesionit të dytë dhe të tretë forumor duhet të bëjnë hulumtime shtesë për problemin për zgjidhjen e ofruar për të. Që të lehtësohet puna, grupeve të punës u jepet formular i përpiluar paraprakisht, me pika të cilave duhet t'ju kushtojnë kujdes (shih Aneksi 17 – Formular për propozim konceptin).

Në këtë forum pjesëmarrësit do të marrin informacione se kush mund të jetë bartës i projektit dhe kriteret për zgjedhjen e projekteve (shih Aneksi 18 – kushtet për bartësin e projektit).

Grupet, problemet të cilët qytetarët i kanë përcaktuar, për të cilët për shkak të



ndryshme (vëllimi i tyre, financa të nevojshme për realizim, kompetencat e NJVL etj.) nuk formohet grup punues për zgjedhjen e tyre, diskutohen në forumin dhe mund të jepen si rekomandime deri te vetëqeverisja lokale për tejkalimin e tyre.

Në fund të sesionit të forumit bëhet marrëveshje për mbajtjen e sesionit të ardhshëm, përcaktohet data dhe koha dhe bëhet vlerësimi i efikasitetit të sesionit me evoluim me shkrim (shih Aneksi 19 – Rend i ditës për sesionin e forumit të dytë).

### FORUMI NDERKOMUNAL

Te ky lloj i forumit procesi vijon njëjtë si te forumi projektues, me atë që sesionet zhvillohen me parimin e rotacionit në secilën prej komunave, kurse transporti i pjesëmarrësve “të ftuarve” në vendin ku mbahet Forumi është i siguruar nga ana e komunave.

Në forumin ndërkomunal Mogillë-Novaci gjysma e sesioneve janë mbajtur në Mogilla, dhe pjesa tjetër në Novaci, ndërsa, forumi ndërkomunal Radovish-Konçe pjesa më e madhe e sesioneve të forumeve janë mbajtur në Radovish, dhe një pjesë e vogël në Konçe.

### FORUMI BUXHETOR

**Sesion i dytë i forumit** fillon me miratimin e procesverbalit nga sesioni i mëparshëm i forumit, pas së cilës vijon prezantimi i grupit punues për propozim- prioritetet. Vijon diskutim për prioritetet për zhvillimin e komunës për vitin e ardhshëm dhe miratimi i propozimeve. Pastaj jepet një pasqyrë e të ardhurave të planifikuara kundrejt atyre të realizuara të komunës për vitin në vazhdim dhe diskutohet për atë. Përfaqësuesit e komunës e prezantojnë projektimin, gjegjësisht planin e të ardhurave për vitin e ardhshëm, pas së cilës vijon diskutim për forumin. Në fund formohet grup punues për përgatitjen e raportit për rekomandimet nga pjesëmarrësit të cilët do të ishin pjesë e buxhetit komunal në vitin e ardhshëm (shih Aneksi 20 – Rendi i ditës për sesionin e forumit të dytë për forum buxhetor).

## HAPI I 7

### Organizimi i sesionit të tretë të forumit

#### FORUM I PROJEKTUES

**Në sesionin e tretë të forumit** prezantohen raportet nga grupet e punës të cilat kanë bërë hulumtim për secilën grup të problemeve dhe kanë zhvilluar zgjidhje për to. Forumi vendos për dhënien e pëlqimit për zhvillimin e konceptit në projekt. Gjegjësisht, çdo grup pune e prezanton konceptin që ka punuar në dy sesionet. Obligohet që secili grup punues për prezantim ta shfrytëzojë formatin e konceptit, ndërsa secili grup ka lirinë për të bërë prezantim të dyfishtë nëse e konsideron të nevojshme. Për shkak të barazisë së prezantimeve do të përcaktohet afati kohor ( p.sh. 10 minuta) në gjatësinë e prezantimit shtesë.

Pastaj diskutohen zgjidhet e propozuara dhe testohet realizimi i tyre. Kur flitet për realizimin, bëhet fjalë për aspektin financiar, kohor dhe teknik. Nën aspektet teknike mendohet për kërkimin e informacioneve nga përfaqësuesit e komunës në lidhje me atë nëse propozim zgjidhjet janë në kompetencë të NJVL-së, a janë në pajtueshmëri me planin e detajuar urbanistik (PDU), cilat janë planet e komunës në lidhje me zgjidhjen, që të mos vijë deri te mbivendosja e disa aktiviteteve/projekteve etj. Me kohë do të thotë të mund të zbatohen në brenda kornizës kohore e cila është në dispozicion, dhe financiarisht të jenë në kuadër të fondit në dispozicion i cili është i përcaktuar për këtë forum. Gjithashtu shqyrtohet dhe nëse zgjidhjet e propozuara janë në pajtueshmëri me temën dhe me kriteret për zgjedhjen e projekteve.

Kjo do të thotë se pas prezantimit të çdo koncepti, forumi (të pranishmit) kanë të drejtë të parashtrajnë pyetje shtesë, dhe pastaj forumi vendos (voton nëpër tavolina) a jep mbështetje grupi punues i cili e ka përpunuar konceptin të vazhdojë ta zhvillojë në formë të projektit.

Në këtë sesion prezantohet formulari për të shkruar propozim- projektin (shih Aneksi 21 – formular për propozim- projektin) para të gjithë pjesëmarrësve në forum dhe këto gupe punuese të cilat kanë fituar të drejtë nga forumi t'i zhvillojnë zgjidhjet e propozuara në projektin e plotë ju jepet detyrë të përpunojnë propozim- projekt deri në sesionin e ardhshëm (shih Aneksi 22 – Rend i ditës për sesionin e tretë të forumit të për forum projektues).



Procesin e përgatitjes së projekteve midis sesioneve e udhëheqin moderatori dhe bashkëmoderatori me përkrahje nga GO dhe përfaqësuesit nga NJVL-ja, dhe sipas nevojës mund të angazhohen edhe ekspertë. Midis sesionit të tretë dhe të katërt është e nevojshme të lihet më shumë kohë, gjegjësisht më së paku një muaj që grupet punuese të kenë kohë të mjaftueshme t'i zhvillojnë projektet dhe buxhetet, si dhe të grumbullojnë minimumin e dokumentimit teknik që të tregojnë se projektet janë të realizueshme dhe mund të zbatohen.

## FORUMI BUXHETOR

**Sesioni i tretë i forumit** fillon me prezantimin e propozimeve të grupit punues për prioritetet në buxhetin për vitin e ardhshëm. Vijnë diskutim dhe propozime shtesë nga ana e pjesëmarrësve. Pas pauzës, vijon prezantim dhe diskutim për shpenzimet në buxhetin e komunës për vitin e ardhshëm sipas kompetencave, p.sh. për aktivitetet komunale (infrastruktura), dhe për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe natyrës etj. Pastaj, tavolinat e punës japin propozime dhe rekomandime. Në fund formohet grup punues për përgatitjen e raportit për rekomandimet dhe propozimet e pjesëmarrësve.

Derisa forumi buxhetor zbatohet në komunë më të madhe me një numër të madh të bashkësive lokale dhe urbane të cilat funksionojnë mirë dhe vazhdimisht shfrytëzohen nga ana e komunës për konsultime, atëherë mund që në ato komuna paralelisht me procesin e forumit të zhvillohen konsultime edhe nëpër bashkësi lokale dhe urbane për nxjerrjen e prioriteteve për çdo vendbanim. Ky proces duhet të përfundojë para mbajtjes së sesionit të 3-të forumor, me qëllim në këtë sesion me propozim të shpenzimeve të planifikuara në programet e zhvilluara për vitin e ardhshëm për qytetin të vijojë prezantimi i prioriteteve të përcaktuara së pari i atyre urbane, dhe në sesionin e ardhshëm të atyre të bashkësive lokale.

Nëse komuna është më e vogël, mund të kërkojë kryetarët e bashkësive lokale dhe urbane vetë me qytetarët t'i përcaktojnë prioritetet në vendbanimet e tyre (para fillimit të sesionit të parë të forumit) dhe pastaj të marrin pjesë në forum, duke i bartur nevojat e qytetarëve nga vendbanimi i tyre në forum dhe duke u munduar që ato të kyçen si prioritare në buxhet.

Në fund vijon diskutim dhe propozim-prioritete nga forumi për programet zhvillimore për komunën për vitin e ardhshëm (shih Aneksi 23 dhe 24 – Rëndësi për sesionin e dytë të forumit buxhetor me dhe pa bashkësi urbane).

## HAPI I 8 ORGANIZIMI I SESIONIT TË KATËRT TË FORUMIT

### FORUMI PROJEKTUES

Në sesionin e forumit të katërt prezantohen projektet të përgatitura nga grupet punuese. Prezantohen qëllimet, rezultatet, aktivitetet dhe buxheti. Pas çdo prezantimi të pranishmit e forumit kanë të drejtë të parashtrajnë pyetje, komente dhe propozime për përmirësimin e projekteve. Lutet forumi që gjatë dhënies së komenteve dhe propozimeve t'i ketë parasysh edhe kriteret për zgjedhjen e projekteve. Gjithashtu, edhe një herë shqyrtohet mundësia e realizimit të projekteve dhe shqyrtohet minimum dokumentimi teknik (p.sh. kompetencat e NJVL-së, PDU-së, fletëpronësitë, pëlqimi nga institucionet dhe partnerët të përfshirë në projekt). Si aspekte kyçëse të cilat shqyrtohen në projektet janë edhe kush do të jetë bartës i projektit si dhe qëndrueshmëria e së njëjtit. Nëse ka sugjerime apo rekomandime për ndryshimin dhe plotësimin e projektit, forumi i dorëzon deri te grupi punues dhe ai është i obliguar t'i pranojë dhe shqyrtojë deri te sesioni i pestë kur do të jetë dhe votimi i projekteve përfundimtare (shih Aneksi 25 – Rendi i ditës për sesionin e katërt forumor për forumin projektues).

### FORUMI BUXHETOR

**Sesioni i katërt të forumit** përfshin prezantimin dhe diskutimin për raportin e grupit punues për rekomandimet dhe propozimet e pjesëmarrësve për programet zhvilluese të buxhetit të diskutuara në sesionin paraprak, të cilat kanë të bëjnë për vitin e ardhshëm. Në përgjithësi, ky sesion është përqendruar në prezantimin dhe diskutimin e programeve dhe projekteve të tjera zhvilluese të tjera në buxhetin e komunës për vitin e ardhshëm. Dhe kështu, p.sh. mund të propozohet me diskutim për kulturë dhe arsim, sociale dhe sport, zhvillim ekonomik etj. Në fund formohet grup punues për përgatitjen e raportit për rekomandimet dhe propozimet nga pjesëmarrësit.

Në komunat më të mëdha forumi fillon me shqyrtimin prioritetive të qytetarëve të propozuara në sesionin e tertë të forumit nga ana e një përfaqësuesi nga grupi punues. Pastaj kryetari i komunës i prezanton shpenzimet e planifikuara sipas programeve zhvilluese për mjediset ru-

rale për vitin e ardhshëm, pas së cilës vijnë pyetje nga të pranishmit dhe diskutim.

Më pas, një përfaqësues i grupit punues jep shqyrtimin e prioritetive të dorëzuara nga bashkësitë lokale. Në fund, tavolinat e punës përcaktojnë propozim-prioritete nga forumi për vendbanimet për vitin e ardhshëm dhe i prezantojnë para forumit (shih Aneksi 26 dhe 27 – Rendi i ditës për sesionin e katërt të forumit për forum buxhetor me dhe pa bashkësi lokale).

Sigurisht, çdo sesion i forumit për të gjitha llojet e forumit fillon me mirëseardhje, kontrollin e aktiviteteve nga sesioni i mëparshëm, si dhe prezantimin e qëllimeve dhe rendin e ditës së sesionit. Gjatë sesioneve, moderatori dhe bashkëmoderatori e përkujtojnë forumin mbi parimet e punës, kriteret për zgjedhjen e projekteve, si dhe rregullat për votim.





## HAPI 9

### Organizimi i sesionit të pestë të forumit

Në forumin pestë zgjidhen projektet të cilat do të financohen në kuadër të fondit në dispozicion dhe përmblihen rekomandimet e dhëna gjatë procesit të forumit.

#### FORUMI I PROJEKTIT

Në seancën e pestë të forumit zgjidhen projektet të cilat do të financohen në kuadër të fondit në dispozicion. Para procesit të votimit, numërohen të pranishmit, bëhet vlerësimi i procesit të forumit në tërësi, si dhe prezantimi i mënyrës së votimit. Rregullohet e drejta e votimit, gjegjësisht të gjithë ata të cilët nuk kanë qenë prezent në forum të paktën tri herë, ulën në publik. Më pas forumit i drejtohen përfaqësuesit e grupeve punuese, me ç'rast shkurtimisht prezantohen projektet dhe theksohen shkaqet përse forumi duhet të votojë për atë projekt. Kët prezantime të grupeve punuese dallohen nga seancat e mëparshme, pasi që forumi është mirë i informuar lidhur me projektet dhe nuk ka nevojë për prezantimin e tyre në detaje. Theksohen vetëm objektivat kyçe të projektit, ajo që do të arrihet dhe buxheti, si dhe bartësi dhe partnerët e projektit. Grupet punuese raportojnë në rast se kanë bërë ndryshime në projekt para seancës ose kanë siguruar ndonjë dokument (ajo varet nëse në seancën paraprake ka pasur vërejtje për përmirësimin e projektit) dhe llojnë që projekti i tyre të votohet (p.sh. ka mundësi që nga ndonjë grup punues të jetë kërkuar të sigurojë letër mbështetjeje nga ndonjë institucion ose dokument prone për të shqyrtuar pronësia etj.).

Pastaj fillon votimi në përputhje me rregullat për zgjidhjen e projektit (shiko Aneksin 28 – rregullat për zgjedhjen e projektit). Bëhet fjalë për modelin e votimit të “Evrovizionit”. Votimi zhvillohet nëpër tryeza pune dhe të gjitha tryezat e punës fillojnë të votojnë në kohë të njëjtë. Të gjitha tavolinave ju ndahen fleta me emrat e të gjitha projekteve. Renditja e emrave në fletën votuese është sipas radhitjes alfabetike (shiko Aneksin 29 – formë e fletëvotimit). Gjatë votimit secila tavolinë e punës jep pikë. Pikët jepen sipas numrit të projektin, p.sh. nëse janë 5 projekte për projektin më mirë të renditur jepen 5 pikë, ndërsa për atë më dobët të



renditur 1 pikë. Secila tavolinë e punës fiton nga 2 fletëvotime dhe në të dyja vendos rezultate identike. Pas votimit të secilës tavolinë moderatori dhe ko-moderatori (ndihmës moderatori) i vulosin të dyja fletëvotimet dhe njëren fletë e marrin me vete. Gjatë votimit tavolinat e punës nuk komunikojnë në mes vete. Votat nuk lexohen përderisa të gjitha tavolinat nuk i dorëzojnë rezultatet e votimit. Pas përfundimit të votimit pason procesi i prezantimit të të njëjtave. Secila tavolinë e punës i lexon rezultatet e votimit dhe në tabelën tanimë paraprakisht të përgatitur (shiko Aneksin 30 – tabela e vlerësimit) e cila projektohet në pëlhurë/mur vendosen votat e secilës tavolinë punuese. Përfaqësues nga çdo tavolinë punuese i lexon votat, përfaqësuesit e organizatorit të forumit/donatorit e kanë fletëvotimin e dytë të tavolinës dhe ndjekin nëse janë të njëjta, ndërsa votat e lexuara vendosen në tabelë. Ashtu fitohet mënyrë shumë transparente e votimit. Pasi secila tavolinë e punës të ketë votuar për projektet, rezultatet mblidhen dhe projekti që do të fiton më shumë vota zgjidhet për implementim. Nëse dy projekte fitojnë numër të njëjtë të votave, aplikohet po i njëjti princip i votimit, por vetëm për ata dy projekte. Të gjitha tavolinat e punës votojnë për të dy projektet dhe votat e çdo **tavoline të punës** mblidhen.

p.sh. në komunën e Koçanit në votim ishin vendosur 10 projekt-propozime dhe gjatë votimit i dyti dhe i treti kishin numër të njëjtë të pikëve. Në vend që të rivotohet, u rinumërua se cili projekt ka fituar më shumë se 9 dhe 10 dhe ai ishte shpallur si dytë.

Në komunën e Karbincit nga 4 projekte të vendosura në votim, i dyti dhe i treti kishin numër të njëjtë të pikëve. U kërkua që secila tavolinë e punës përsëri të votojë për vetëm këto dy projekte. Në komunën e Gjorçe Petrovit kishte 2 projekte të vendosura në votim dhe për shkak se numri i tavolinave të punës ishte çift (10), tryeza e administratës komunale u tërhoq nga votimi.

Me qëllim që procesi i votimit të jetë i suksesshëm, nevojitet përgatitje e mirë dhe koordinim me Grupin operativ i cili ka detyra të caktuara gjatë seancës.

Në fund të seancës, lista e rekomandimeve e firmosur nga të gjithë qytetarët i dorëzohet kryetarit të komunës dhe qytetarët informohen për aktivitetet e ardhshme, gjegjësisht jepet pasqyrë e shkurtër se si do të rrjedhë procesi i implementimit të projektit (shiko Aneksin 31 – Rendi i ditës i seancës së pestë të forumit për forumin e projektit).

Për zbatimin e rekomandimeve përgjegjëse është komuna. Në seancën e fundit u formua grupi punues i cili ka për detyrë ta përcjell zbatimin e rekomandimeve. Para seancës së mëvonshme, përgatitet raporti për atë se cilat rekomandime janë zbatuar dhe bëhet prezantimi në forum.

## FORUMI BUXHETOR

Në **seancën e pestë** qytetarët vendosin, gjegjësisht zgjedhin se cili program është me prioritet dhe cili projekt në kuadër të atij programi do të zbatohet me fondin i cili është siguruar për atë forum. Në pjesën e parë të seancës së forumit prezantohen rezultatet e procesit të forumit, gjegjësisht forumi informohet se sa projekte dhe rekomandime të cilët i kanë propozuar qytetarët janë të përfshirë në programet dhe cilët propozime të qytetarëve nuk janë pranuar dhe pse. Këtë e prezanton komuna, por e përgatit së bashku me grupin punues dhe ka të bëjë me

të gjitha rekomandimet dhe propozimet që kanë qenë të diskutuar nëpër seanca. Para procesit të votimit, bëhet regjistrimi i prezencës, vlerësimi i tërë procesit, si dhe prezantimi i mënyrës së votimit dhe rregullimi i të drejtës së votës, gjegjësisht të gjithë ata të cilët nuk kanë marrë pjesë në forum të paktën tri herë, ulen në publikë. Më pas vijon prezantimi i programeve të cilët vendosen në votim. Secila tavolinë e punës voton, gjegjësisht vendos dhe zgjedh program me prioritet. Menjëherë pasi të zgjidhet programi me prioritet me numër më të madh votash, kalohet drejt prezantimit të projekteve në kuadër të atij programi dhe votimit të projektit në përputhshmëri me kriteret për zgjedhjen e projekteve. Në fund formohet grupi punues për të përfaqësuar dhe monitoruar propozimet e forumit, rekomandimet dhe projektet të cilët i dorëzohen kryetarit të komunës, të firmosur nga të gjithë pjesëmarrësit e forumit. Grupi punues duhet të përbëhet nga përfaqësues të të gjitha tavolinave të punës dhe do të merr pjesë në mbledhjet e Këshillit të komunës dhe në mbledhjet e komisioneve pranë Këshillit të komunës me qëllim që të prezantohen dhe të përfaqësohen propozimet e forumit. Grupi punues gjithashtu do ta ndjekë realizimin e projekteve të zgjedhur dhe do të merr pjesë në mbledhjet për ndryshim/rebalanc të buxhetit (për programet të cilët ishin prezantuar dhe diskutuar në forum shiko Aneksin 32 – Rendi i ditës për seancën e pestë të forumit buxhetor).



## HAPI 10-të Realizimi i projekteve të zgjedhura

Për realizimin e projekteve të zgjedhura përgjegjës është bartësi i projektit i cili përcaktohet nëpër seancat e forumeve dhe i cili duhet të firmos kontratë me komunën ose donatorin e fondeve të forumit. Bartësi i projektit duhet të emërojë koordinator të projektit (shiko Aneksin 33 – përshkrimi detyrave të punës së koordinatorit të projektit). Ai/ajo duhet të kujdeset që të gjithë aktivitetet e parapara të projektit të zbatohen në përputhshmëri me afatin kohor dhe buxhetin. Për më tepër, vazhdimisht duhet të jetë në koordinim me komunën (nëse komuna është bartës i projektit) dhe ta informon publikun për ecurinë e projektit.

Nëse bëhet fjalë për projekte të infrastrukturës, realizimi i projekteve fillon me përgatitjen e dokumentacionit teknik i cili duhet të përgatitet në përputhshmëri me ligjet në fuqi, në veçanti me ligjin për ndërtim. Komunë është përgjegjëse për të siguruar dokumentacionin projektit/ teknik, studimet, hartimet etj. dhe e njëjta duhet ta kolon tërë procedurën në përpunimin e dokumentacionit të duhur të projektit/teknik. Pasi që dokumentacioni teknik të jetë i përgatitur dhe i miratuar nga personi i autorizuar, fillon faza e procedurës së tenderit në përputhshmëri me Ligjin për prokurim publik. Në raste kur ka projekte në të cilët është e nevojshme shpërndarja e mallrave ose shërbimeve, atëherë duhet të përgatitet specifikim i detajuar.

Nëse të gjitha ose pjesën më të madhe të mjeteve i siguron donatori, atëherë mund të përfitojnë nga neni 9 i Ligjit për prokurim publik i cili jep mundësi që donatori të përcakton kushtet e procedurës së tenderit, gjegjësisht jep mundësi për shkurtimin e kohëzgjatjes së procedurës së tenderit dhe kufizim të së drejtës për ankesë.

Pas zgjedhjes së kompanive (kontraktues, mbikëqyrës dhe furnizues) dhe firmosje së kontratave me to, bartësi i projektit duhet të mbajë mbledhje me partnerët në të cilën do të informonte se cilat kompani janë zgjedhur, do të informonte për dinamikën e pritur kohore dhe do të diskutonin për rolin e tyre në çdo fazë të projektit. Bartësi i projektit duhet të jetë në kontakt të vazhdueshëm dhe në koordinim me partnerët.

Mbikëqyrjen profesionale mbi kryerjen e punëve të projektit e bën inxhinieri i zgjidhur në tender, por monitorim mund të bën edhe komuna,







si dhe grupi punues i cili formohet në seancën e fundit në aspektin nëse të gjitha aktivitetet e parapara rrjedhin dhe zbatohen sikur që janë votuar nga forumi.

Me rëndësi të madhe është i tërë procesi i zbatimit të projektit të jetë transparent dhe qytetarët rregullisht të informohen mbarëvajtjen e projektit në medie dhe përmes faqes së internetit të komunës. Grupi punues i cili u formua në seancën e fundit të forumit dhe i cili e ndjek zbatimin e rekomandimeve, gjithashtu e ndje edhe zbatimin e projektit. Transparenca e këtij procesi, si dhe implementimi i suksesshëm i projektit, është me rëndësi shumë të madhe, pasi që me këtë komuna e fiton besimin e qytetarëve dhe e siguron pjesëmarrjen e tyre në proceset e ardhshme të forumit.





## HAPI I 11-të Organizimi i seancës së mëvonshme

Seancë e mëvonshme mbahet pas përfundimit të projektit të zgjedhur/ zbatimit të konkluzioneve të forumeve/ fundit të vitit buxhetor.

Seanca e mëvonshme shërben për të dhënë informacione kthyesë për projektet dhe rekomandimet e zbatuara.

Në seancë thirren të gjithë që kanë marrë pjesë në procesin e seancave të forumit, si dhe i gjithë publiku. Komuna e bën prezantimin e rezultateve të Forumit, projektet dhe rekomandimet e zbatuara.

Organizohet pasi që projektet të zgjedhur të jetë zbatuar dhe në të janë të ftuar të gjithë qytetarët përmes ftesave të drejtpërdrejta, telefonatave, përmes medieve, pllakateve, postës elektronike (e-mail). Bartësi i projektit duhet të përgatit prezantim për tërë procesin e zbatimit të projektit. Është mirë që prezantimi të jetë i pasuruar me fotografi të aktiviteteve të projektit, dhe nëse bëhet fjalë për ndërtimin e objekteve dhe ndërhyrjet në infrastrukturë të ketë fotografi para, gjatë, dhe pas aktiviteteve ndërtimore. Komuna është përgjegjëse për të përgatitur prezantim për rekomandimet dhe ta informojë forumin se cilët prej tyre ishin zbatuar (Aneksi 34 – rendi i ditës për seancën e mëvonshme). Në forumin buxhetor prezantimin e bën grupi punues i cili e ndjek procesin e miratimit të buxhetit dhe realizimin e tij. Ai informon për atë se si ka rrjedhur procesi dhe çka është realizuar nga e planifikuara.



## KREU 5 SFIDAT E PROCESIT TË FORUMIT

Çdo proces sjell sfidat e veta, po ashtu edhe ky. Duke i ditur sfidat, procesi mund të organizohet dhe të udhëhiqet më mirë dhe për këtë arsye kemi vendosur që një pjesë të tyre ti theksojmë në këtë doracak, duke besuar se kjo do ta lehtëson procesin dhe do të mundëson kualitet më të larta të seancave të forumit:

### • Kontratë për objektivat e forumit

Që forumi të jetë i suksesshëm, të gjithë pjesëmarrësve duhet t'iu jetë e qartë përse ai po ndodh. Moderatorin duhet ti sqaron objektivat dhe procesin e forumit. Ai/ajo duhet ta prezanton veten dhe të gjithë të tjerët të cilët luajnë rol të veçantë në proces (ko-moderatori, grupi punues, etj.) dhe të sqaron se ku fillon forumi dhe ku duhet të arrin, d.m.th. kur dhe si do të përfundon. Qytetarëve duhet t'iu shpjegohet çfarë do të jetë angazhimi i tyre, gjegjësisht çfarë pritet prej tyre. Kjo duhet të bëhet në seancën e parë të forumit.

### • Puna me tryeza punuese

Tavolinat e punës janë mjetet kryesore përmes së cilave punon Forumi. Formimi i tavolinave të punës bëhet në seancën e parë dhe qytetarët marrin pjesë dhe diskutojnë në forum nëpërmjet tavolinave të tyre punuese. Është shumë vështirë që në forum me 60 ose 100 persona të sigurohet mundësi që secili ta merr fjalën. Atëherë seanca e forumit do të zgjaste më shumë se 3 orë. Megjithatë, 6 ose 8 persona në një tavolinë shumë lehtë mund të merren vesh. Duke i obliguar tavolinat punuese me detyra të ndryshme, i mundëson moderatorit rast që ta dëgjojë mendimin e palëve të ndryshme të shqetësuar. Pjesëmarrësit, e tavolinave të punës lirisht mund ti tregojnë mendimet e tyre, por edhe të arrijnë konsensus në tavolinën e tyre. Më pas në diskutimet para forumit secila tavolinë e shpreh qëndrimin e vet dhe përmes debatit arrihet konsensusi i forumit. Puna nëpër tavolinat punuese krijon konkurrencë pozitive midis palëve të ndryshme të shqetësuar dhe e rrit përgjegjësinë e pjesëmarrësve, dhe njëkohësisht mundëson efikasitet në punën e forumit.

### • Zgjidhja e vendit për mbajtjen e forumit

Vendin për mbajtjen e forumit e siguron komuna dhe zgjidhja duhet të bëhet në periudhën përgatitore, para mbajtjes së forumit. Gjatë zgjedhjes së vendit duhet pasur kujdes që ai lehtë të njihet në mes dhe ti përshtatet nevojave të ngjarjes.

Gjatë zgjedhjes së vendit për mbajtjen e forumit duhet pasur kujdes që ai të jetë:

- hapësirë e madhe, e hapur në të cilën qetë mund të mblidhen më shumë njerëz dhe të vendosen tavolinat në gjysmë rreth (të paktën 10) dhe pajisjen e nevojshme ndihmëse (tabelat, prozhektor, pajisje për përkthim, zmadhues etj.). Nuk guxon të ketë karrige të fiksuara dhe duhet të ketë hapësirë për të lëvizur moderatori dhe pjesëmarrësit.

p.sh. hapësirat më shpesh të shfrytëzuara për forumet e deritanishme ishin korridorët e mëdha të shkollave, shtëpive të kulturës, restoranteve.

- të jetë i arritshëm për të gjithë personat (p.sh. për personat me aftësi të kufizuara);
- të ketë kushte të përshtatshme për punë në të gjitha stinët (p.sh. ngrohje gjatë dimrit, dhe kondicioner gjatë verës). Këtë duhet pasur parasysh, sepse seancat e punës zgjasin 2 deri në 3 orë;
- të jetë mirë i ndriçuar (jo shumë errët, por edhe jo shumë i ndritshëm);
- të jetë lehtë i arritshëm që të gjithë qytetarët të mund të arrijnë tek ai (p.sh. të jetë në qendër të komunës) ose të ketë transport deri në vend.

Në praktikën e deritanishme vendi dhe koha e mbajtjes së forumit shpeshherë ishin të caktuar gjithnjë në ditën dhe vendin e njëjtë, me qëllim të sigurohet vazhdimësia e forumit. Megjithatë kishte raste (p.sh. në komunën e Novo Selos) seancat të organizoheshin në fshatra të ndryshme. Në forumin ndër-komunal në Mogillë dhe Novaci seancat organizoheshin radhazi në të dy komunat.

### • Zgjidhja e kohës për mbajtjen e forumit

Koha e mbajtjes së forumit është diçka për të cilën merren vesh në forum dhe është e pranueshme për shumicën e pjesëmarrësve. Kohën e mbajtjes së seancës së parë të forumit e propozon grupi operativ, sepse ai përbëhet nga përfaqësues të palëve të ndryshme të shqetësuara të cilat do të jenë pjesëmarrës në forum. Pastaj, në seancën e parë të forumit bëhet një marrëveshje me të pranishmit për ditën dhe kohën e mbajtjes së forumeve të ardhshëm. Koha e mbajtjes së forumit varet nga kontesti lokal në çdo komunë. Sipas përvojës, koha e mbajtjes së forumit ka qenë e ndryshueshme, gjegjësisht ka pasur seanca të forumit të organizuara edhe para dite (12:00) edhe pas dite (17:00) edhe në orët e mbrëmjes (19:00 ose 20:00), në përputhshmëri me kërkesat e qytetarëve dhe specifikat e komunave në të cilat organizohet forumi, ose shprehitë e punës dhe kultura e jetës.

p.sh. në komunën e Novo Selos si komunë rurale koha e mbajtjes së seancave ndryshonte varësisht nga periudha vjetore; gjatë dimrit më herët, në ora 16:00, në pranverë kur filluan punët bujqësore, më vonë – në ora 20:00. Në mjediset urbane, si p.sh. në komunën e Aerodromit, forumi më së shpeshti fillonte në ora 17:00.

Është e dëshirueshme që vendi dhe koha e mbajtjes së forumit të jenë gjithnjë të njëjtë gjatë tërë procesit të forumit dhe të jenë të shkruar në të gjitha pllakatet dhe ftesat të cilat do të shërbejnë për informimin e qytetarëve. Kjo praktikë është e mirë sepse tek njerëzit krijohet shprehia për ardhjen në Forum, më lehtë mund ta planifikojnë kohën e tyre dhe të përgatiten.

p.sh. në komunën e Koçanit seancat janë mbajtur çdo të mërkure të fundit për çdo muaj, në orën 17:00.

### • Udhëheqja e diskutimeve të forumit

Forumit si proces është menduar si vend për shkëmbimin e ideve të cilat do të kontribuojnë për zgjidhje më të mira, për këtë arsye diskutimi aktiv është i domosdoshëm. Moderatori dhe ko-moderatori vetëm e udhëheqin procesin, përderisa qytetarët, d.m.th. pjesëmarrësit e forumit, janë ata të cilët duhet të japin propozime, ti shprehin mendimet

e tyre, të diskutojnë dhe vendosin. Për këtë arsye, moderatori gjithnjë duhet ti motivon dhe ti inkurajon pjesëmarrësit e forumit që ti shprehin mendimet dhe qëndrimet e tyre lidhur me çështjet që i diskutojnë, duke shfrytëzuar metoda dhe teknika të ndryshme për pjesëmarrje.

Diskutimet e forumit gjithnjë janë udhëhequr nga tema e dhënë (p.sh. buxheti në forumet buxhetore), gjegjësisht ajo e cila është zgjedhur nga pjesëmarrësit e seancës së parë të forumit. Ata kanë disa karakteristika:

- **Participim.** Të gjithë pjesëmarrësit e forumit (me përjashtim të anëtarëve të Grupit operativ) kanë të drejtë të marrin pjesë në diskutimet e forumit pa marrë parasysh a janë pjesë e tavolinave të punës ose ulen në publik.
- **Konsensus.** Pjesëmarrësit e forumit, përmes tavolinave të punës, i sjellin të gjitha vendimet me konsensus.
- **Moderator.** Që të arrihet që secili pjesëmarrës i forumit të ndjehet i lirë që ta shpreh mendimin e tij dhe të gjithë të jenë dakord, d.m.th. të arrijnë marrëveshje mbi ndonjë çështje i rëndësishme është moderimi i mirë i cili në asnjë moment nuk e harron rezultatin përfundimtar të çdo seance të forumit.
- **Diskutime të orientuara drejt rezultateve.** Çdo seancë e forumit ka qëllim konkret i cili në fillim ju prezantohet pjesëmarrësve dhe që realizohet në fund të seancës. Qëllimi përfundimtar i forumeve janë projektet dhe rekomandimet e përgatitura.

#### • **Bashkëpunimi në mes moderatorit dhe ko-moderatorit**

Moderatori dhe ko-moderatori janë ekip i cili bashkërisht i udhëheqin qytetarët nëpër forum. Këta dy persona para fillimit të procesit të forumit, sikur para çdo seance të forumit, duhet ti shpërndajnë rolet dhe detyrat e tyre që të jetë e qartë se kush çka do të bëjë. Ekipi para çdo seance zhvillon plan për udhëheqjen e seancës në të cilën qartë është e precizuar se çka do të bëhet gjatë seancës, si dhe cili prej tyre çfarë roli ka. Moderatorit dhe ko-moderatori përveç komunikimit gojor duhet ta ndjekin me kujdes edhe komunikimin jo-verbal të pjesëmarrësve të forumit. Shpeshherë mimika e njerëzve dhe mënyra e mbajtjes së trupit transmetojnë mesazhe të ndryshme, si p.sh. se ju intereson ose nuk ju intereson tema, se janë të lodhur nga diskutimi i caktuar, se është e

nevojshme të bëhet një pauzë, se diçka nuk është plotësisht e qartë etj. Përcjellja e këtyre mesazheve mund të lehtëson udhëheqjen e procesit dhe të bën më të këndshëm për të gjithë pjesëmarrësit. Kur pjesëmarrësit do të vërejnë se moderatori i përcjell ata dhe reagimet e tyre do të jenë më të hapur për bashkëpunim dhe më të gatshëm për pjesëmarrje. Për këtë arsye është e nevojshme që të dy personat gjithnjë të jenë të koncentruar në forumin, në pjesëmarrësit dhe ta ndjekin njëri tjetrin. Ata, paraprakisht, mund të merren vesh për atë se si të kuptohet gjuha e trupit. Vetëm koordinimi i shkëlqyeshëm dhe kontakti vizual midis këtyre dyve do të mundëson rrjedhë të seancës pa pengesa.

#### • **Rekomandimet e forumit**

Rekomandime e dala nga seancat e forumeve janë njësoj të rëndësishme sikur projektet. Në fakt ato janë vendime dhe/ose ide të qytetarëve për probleme të caktuara në bashkësinë të cilat nuk mund të realizohen në periudhën përderisa zgjat forumi, nuk janë në kompetenca të drejtpërdrejta të vetëqeverisjes lokal ose, nuk janë në lidhje me temën e forumit, por megjithatë zgjidhja e tyre është e rëndësishme për qytetarët. Shpeshherë një pjesë e rekomandimeve nuk kërkojnë intervenime të mëdha, por megjithatë janë të rëndësishme (p.sh. të sigurohet sigurimi e shkollave, rregullisht të pastrohet dhe të mirëmbahet parku dhe bregu i lumit etj.).

Në rekomandimet përfshihen edhe projekt-propozimet të cilët në seancën e pestë të forumi nuk arriten të hynë në kuadër të fondit për realizimin e projekteve. Jo çdo propozim i dhënë nga qytetari është rekomandim nga forumi. Për të qenë rekomandim, i gjithë forumi duhet ta diskuton propozimin dhe të bie dakord se është i rëndësishëm dhe se duhet të zgjidhet në të ardhmen, më pas ta shpall për rekomandim. Rekomandimet mblidhen gjatë gjithë procesit të forumit dhe në seancën e pestë të forumit lista me rekomandime e firmosur nga të gjithë pjesëmarrësit e forumit i dorëzohet kryetarit të komunës nga ana e një pjesëmarrësi apo një grup pjesëmarrësish. Komuna ka për detyrë që ti merr parasysh rekomandimet e dorëzuara nga forumi dhe të përpikt që ti realizon. Në seancën e mëvonshme, të gjashtë, përfaqësuesi i komunës duhet të deklarohet për rekomandimet, d.m.th. të tregojnë se çka ka arrit të bën komuna në lidhje me ta (që ti realizon, ti vendos në buxhetin e vitit të ardhshëm, ti përfshin në planin strategjik, të drejtohet në institucion tjetër kompetent etj.).

p.sh. në komunën e Prilepit ishin zhvilluar tetë projekt-propozime, nga të cilët 2 ishin financuar nga fondi i projektit, përderisa të tjerët komuna mori përsipër të gjejë donator. Katër prej tyre janë realizuar nga komuna me ndihmën e donatorëve të tjerë, ndërsa një është marrë nga Qeveria dhe do të realizohet në nivel nacional (në mbarë vendin). Në komunën e Berovës ishin zhvilluar shtatë projekt-propozime nga të cilët një ishte financuar nga fondi i projektit. Një nga projektet e mbetur komuna e realizoi me mbështetjen e një agjencie qeveritare.

#### • Sigurimi i pjesëmarrjes së përhershme në forum

Sa më i madh të jetë numri i pjesëmarrësve aq "peshë" të madhe ka forumi, gjegjësisht vendimet e tij janë me rëndësi më të madhe për vetëqeverisjen lokale. Për këtë arsye moderatori, ko-moderatori dhe grupi operativ gjithnjë duhet të punojnë në promovimin e forumit, rëndësia e tij dhe rezultatet, për të kontribuar për mbajtjen ose rritjen e numrit të pjesëmarrësve. Ndonjëherë ndodh që të ketë nevojë që të rritet numri i pjesëmarrësve, gjegjësisht të vijë deri te zvogëlimi i numrit të pjesëmarrësve të seancave (kjo ndodh shpesh në mes të seancës së dytë dhe të tretë, nëse ndonjë nga vendimet e propozuar nuk mund të zhvillohet në projekt). Atëherë është e nevojshme që të organizohet proces më intensiv i mobilizimit të qytetarëve në mes të seancave, duke shfrytëzuar teknika të ndryshme të cilat tanimë i kemi përshkruar më lart. Në këtë proces, është e nevojshme të përfshihet i gjithë ekipi i forumeve, gjegjësisht Njësitë e Vetëqeverisjes Lokale, moderatori, ko-moderatori dhe Grupi operativ. Njëherit, është shumë e rëndësishme që të zbulohet shkaku i zvogëlimit të numrit të qytetarëve që të mund të zgjidhet teknika më e mirë për mobilizimin e tyre të sërishëm. "Vegla" më e mirë për përfshirjen e qytetarëve është aktivizimi i tyre në punën mes seancave, në vendimet dhe projektet. Në atë mënyrë qytetarët japin kontribut më aktiv, zhvillojnë ndjenjë më të madhe për përgjegjësi ndaj vendimeve të propozuara dhe e mësojnë procesin e zhvillimit të projekt-propozimeve.

p.sh. nëse një grup i caktuar i qytetarëve tërhiqet për arsye se ideja e tyre për projekt nuk pranohet nga forumi, duhet të organizohet takim me ta dhe t'iu tregohet mundësia që mbështetjen e tyre ta japin në grup tjetër punues. Nëse, akoma numri i qytetarëve është jo i mjaftueshëm që nga fillimi i procesit të forumit, atëherë është e nevojshme që të shpjegohet qëllimi i procesit dhe rëndësia e pjesëmarrjes së qytetarëve, si dhe përfitimet të cilat do ti kenë qytetarët nga pjesëmarrja e tyre.

#### • pjesëmarrja në tryezat punuese

Që nga seanca e parë e forumit pjesëmarrësve duhet që t'iu shpjegohet se vendimi për pjesëmarrje në një tavolinë punuese është përfundimtar, gjegjësisht se nuk duhet të ketë zhvendosje nga tryeza punuese në tryezë punuese. Me këtë kontribuohet për vazhdimësinë e tavolinave të punës e cila është e domosdoshme për funksionimin e forumit. Natyrisht, ka mundësi që interesi i një kategorie të caktuar të njerëzve të humbet dhe ata të largohen nga procesi i forumit, por që tryeza të ketë të drejtë vote është e domosdoshme që në të të ulen të



paktën 3 persona të cilët do të jenë të rregullt në forum (secili person i tavolinës do të marr pjesë së paku në 3 seanca të forumit)

Gjatë procesit të seancave të forumit, ndodh që qytetarët të mos marrin pjesë vazhdimisht nga tryeza e njëjtë punuese dhe kështu të mos e fitojnë të drejtën për të votuar në seancën e fundit. Prandaj është e domosdoshme që në fillim të shpjgohet se e drejta e votimit nga tryeza punuese e caktuar fitohet vetëm me pjesëmarrje të rregullt në tavolinën e njëjtë punuese gjatë gjithë procesit, si dhe të theksohet nevoja për pjesëmarrjen në të paktën 3 seanca, duke përfshirë edhe seancën e 5-të. E vlen që ky rregull të theksohet në fillim të çdo seance, dhe njëherit Grupi operativ ta monitoron praninë e qytetarëve nëpërmjet listave të pjesëmarrësve dhe nëse vërehet ndryshim të tavolinave të punës, atëherë ta njoftoj moderatorin i cili do të tregojë për të dhe do ta përkujton rregullën e vazhdimësisë së tavolinave të punës. Nëse në seancën e fundit në votim vërehet se një pjesë e qytetarëve nga tryeza të ndryshme megjithatë kanë marrë pjesë, atëherë votojnë nga tryeza punuese nga e cila më së shumti kanë marrë pjesë (p.sh. nëse nga 5 seanca të pranishme, tri herë janë regjistruar në tryezën punuese arsimimi, dhe dy herë në tavolinën punues shëndetësia, atëherë votojnë nga tryeza e punës arsimimi). Nëse, pjesëmarrësi ka numër të njëjtë të pjesëmarrjes në dy punuese – dy herë në arsimim dhe dy herë në shëndetësi- atëherë voton nga tryeza e punës në të cilin ka qenë i ulur në seancën e katërt të forumit.

• **Rregulli „1 tryezë = 1 votë**

Pjesëmarrësve që nga formimi i tavolinave të punës duhet t’iu shpjgohet se gjatë votimit të gjitha tavolinat e punës do të jenë të barabarta. D.m.th. asnjë tavolinë e punës (p.sh. vetëqeverisja lokale, të rinjtë etj) nuk do të ketë përparësi gjatë votimit. Gjithashtu, pjesëmarrësve duhet t’iu shpjgohet se numri i personave të cilët ulen në tavolinat nuk ndikon në procesin e votimit, sepse një tavolinë ka të drejtë për një votë.

p.sh. nëse në një tavolinë punuese ulen 4 persona, ndërsa në tjetrën 10, gjatë votimit edhe njëra edhe tjetra do të kenë nga një votë.



• **Të paktën 3 pjesëmarrje për të drejtën e votës**

Për vendimet e forumit, para së gjithash – renditja e projekteve në seancën e pestë, që të kenë “peshë” më të madhe përcaktohet numri minimal i pjesëmarrjeve. Që personat të kenë drejtë të votojnë në tryezën e tyre duhet të kenë marrë pjesë të paktën në 3 seanca, duke përfshirë edhe seancën e fundit, të pestë. Personat me pjesëmarrje më të vogël nuk do të marrin pjesë në procesin e vendosjes.

Rregulli se një tryezë ka një votë dhe se qytetarët duhet të marrin pjesë të paktën në 3 seanca të forumit për të fituar të drejtën për votim shpjgohet në fillim të procesit të forumit dhe është pjesë e parimeve të punës. Moderatorin duhet të kujdeset që ky parim qartë të vendoset dhe të respektohet. Pjesëmarrja e qytetarëve përcillet dhe evidentohet në lista të pjesëmarrësve të cilat qytetarët i nënshkruajnë në çdo seancë të forumit. Pasi që ndodh që qytetarët nuk e përcjellin tërë seancën (ndodh që të nënshkruhen në fillim të seancës dhe pastaj të ikin), rekomandohet që listat e pjesëmarrësve të jepen për firmosje pas pauzës, me qëllim që të sigurohet pjesëmarrja gjatë gjithë seancës.



#### • Përfshirja e ekspertëve

Ekspertët gjithmonë përfshihen kur ka nevojë për mendimin e tyre. Ata ftohen në seancat e forumit për të dhënë informata dhe mendime për problemet e përcaktuara dhe për zgjidhjet e propozuara dhe mund të ftohen në takimet e punës në mes seancave të forumit ku do të ndihmojnë në krijimin e koncepteve dhe të projekteve.

Procesi i forumit do të ketë kualitet më të lartë dhe do të arrin efektivitet nëse përfshihen ekspertë gjatë seancave dhe në punën në mes seancave. Në forum duhet të sigurohet pjesëmarrje e njerëzve profesional me ekspertizë të ndryshme varësisht nga tema dhe problemi për të cilat diskutohet. Ato mund të jenë përfaqësues të Njërive të vetëqeverisjes lokale, ekspertë lokal, ose kombëtar, dhe në përputhshmëri me këtë forumi ka në dispozicion ekspertizë të brendshme dhe të jashtme. Megjithatë, përfshirja e ekspertëve bart sfidën e vet, sepse është shumë e rëndësishme se si do të prezantohen para forumit dhe si do it shfaqin mendimet dhe qëndrimet e tyre për çështje të caktuara që të mos ndodh që forumi të ketë përshtypjen se diçka po ju imponohet ose në vend të tyre dikush tjetër merr vendime. Të mos harrojmë se motoja

kyçe e procesit është “Qytetarë vendosin” dhe për këtë arsye është e domosdoshme që përfshirja e ekspertëve të bëhet me kujdes, gjegjësisht të shpjegohet i gjithë roli i përfshirjes së tyre.

p.sh. një grup i qytetarëve propozon që të hapet një qendër për kujdesin e viktimave të dhunës familjare. Në seancën e radhës, ftohen përfaqësues nga Ministria e punë dhe politikës sociale të cilët punojnë në këtë temë, me qëllim që të sigurojnë informata për rregullat për hapjen e një qendre të tillë, të dhëna për numrin e viktimave të regjistruara në komunën gjegjëse, me qëllim që të përcaktohet nëse vërtetë ka nevojë për një qendër të tillë dhe njëherit ti prezantojnë planet në nivel kombëtar (për mbarë vendin) që të mos vijë deri te mbivendosja e aktiviteteve.

Pas raportit duhet të lihet hapësirë që forumi të sjellë vendim nëse dhe si do të zbatohet ideja e projektit, sepse në të kundërtën forumi mund ta përjeton pjesëmarrjen e tyre si imponim të ndonjë qëndrimi të caktuar ose të marrjes së vendimit. Sfida kyçe në lidhje me ekspertët është që ata të japin informata dhe të dhëna të cilat do t’iu ndihmojnë qytetarëve të marrin vendim të duhur, por jo dhe të vendosin në vend të tyre. Ndonjëherë ka nevojë që ekspertët të japin informata të cilat do t’iu tregojnë qytetarëve se duhet ta ndryshojnë vendimin e tyre. Kufiri në mes konsultimit qëllimor dhe imponimit të vendimit është i hollë dhe për këtë arsye duhet pasur shumë kujdes. Megjithatë kjo kërkon edhe përgatitje të mirë të ekspertëve për pjesëmarrjen e tyre në forum dhe për këtë arsye duhet që moderatori paraprakisht të takohet me ekspertët dhe t’iu shpjegon procesin dhe objektivin e pjesëmarrjes së tyre.

#### • Dinamika në mes seancave (grupet punuese)

Siç theksuam shumë herë, strukturën e forumit e përbëjnë tryezat e punës dhe e gjithë puna e forumit zhvillohet përmes tyre. Megjithatë, procesi i forumit nuk përbëhet vetëm prej seancave të forumit. Pjesa më e madhe e punës për të cilën diskutohet në forum zhvillohet në mes seancave. Diskutimi i forumit zhvillohet edhe në tryezat e punës (kur ata duhet të merren vesh rreth qëndrimin të tyre) dhe para të gjithë pjesëmarrësve të forumit (kur të gjitha tryezat i paraqesin qëndrimet e tyre dhe debatojnë lidhur me to). Përfaqësuesit e tryezave të ndryshmet punës formojnë grup punues. Grupi punues formohet me qëllim që të



përfundohet ndonjë detyrë midis dy takimeve të forumit dhe të paktën duhet të ketë 3 anëtarë. Anëtarët duhet të jenë të tryezave të ndryshme punuese. Grupet punuese mbajnë mbledhje midis seancave të forumit dhe në to i përfundojnë detyrat e dhëna. Komuna duhet të siguron kushte për mbledhjet e grupeve punuese, ndërsa moderatori dhe/ose ko-moderatori ti ndihmon në të.

p.sh. pas seancës së parë të forumit formohet grupi punues i cili merr për detyrë të përgatit raport/prezantim të shkurtër mbi gjendjen në komunë në temën e cila është zgjedhur në seancën e parë të forumit, p.sh. nëse tema e zgjedhur është arsimimi, grupi punues duhet ta analizojë gjendjen në komunë mbi çështjen e arsimimit dhe ti paraqet rezultatet e tij para forumit në seancën e radhës.

Aktivitetet në mes seancave në përgjithësi i udhëheq ko-moderatori nën menaxhimin e moderatorit. Roli i Grupit operativ dhe i komunës në këtë proces është shumë i rëndësishëm. Menjëherë pas çdo seance organizohen takime në mes të moderatorit, ko-moderatorit dhe Grupit operativ, me qëllim që të shqyrtohet ajo që është arritur në seancën e forumit dhe cilat janë detyrat deri në seancën e radhës. Pas çdo seance përgatitet procesverbal (shiko Aneksin 35-formë e procesverbalit nga seanca e forumit) nga seanca e forumit, rregullohen listat e pjesëmarrësve dhe të gjitha materialet të cilat dalin nga vetë seanca (p.sh. lista e problemeve, lista e propozim-vendimeve, lista e anëtarëve të grupeve punuese etj.). Ko-moderatori së bashku me Grupin operativ janë përgjegjës për këto detyra. Njëherit diskutohet për problemet dhe sfidat me të cilat janë ballafaquar në seancë dhe përcaktohen zgjidhje dhe vendime si të veprohet në situata të ngjashme në të ardhmen.

Në mes seancave, grupet punuese punojnë në hulumtimin e problemeve, hulumtimin e mundësisë së zgjidhjeve dhe/ose të ideve të projekteve, si dhe përgatitjes së projektpropozimeve dhe rekomandimeve. Menjëherë pas seancave organizohen mbledhje me grupet punuese që të jepen udhëzime dhe shpjegime në lidhje me detyrat e përcaktuara. Për disa nga detyrat (p.sh. hulumtimi i gjendjes në kuadër të temës së zgjedhur) caktohet afat deri kur duhet të kryhet detyra dhe caktohet datë parimore për takimin e radhës të grupeve punuese para seancës, me qëllim që të bëhet kontroll nëse detyra është kryer dhe të shihet nëse ka

nevojë për plotësime dhe për përmirësime. Takimet shfrytëzohen edhe për shqyrtimin dhe diskutimin e rekomandimeve dhe realizimin e tyre.

Grupet punuese duhet të kenë detyra dhe udhëzime të qarta dhe të fitojnë mbështetje të vazhdueshme nga ekipi i forumeve. Në këto takime, qytetarët, pjesëmarrësit në grupet punuese, fitojnë njohuri për përgatitjen e projekteve dhe të njëjtat i përdorin në praktikë gjatë formulimit të projekteve të forumit dhe zhvillimit të aplikacionit të projektit. Gjatë këtij procesi, komuna siguron informata dhe të dhëna për vetë projektet dhe ekspertiza për grupet punuese (trajnuar, ekspertë nga sfera e urbanizimit, konsultues teknik, etj.). Ko-moderatori e organizon punën në mes seancave dhe është lidhja kyçe midis qytetarëve d.m.th. grupeve punuese, Grupit operativ, moderatorit dhe komunës. Ai/ajo i organizon takimet në mes seancave dhe kujdeset që detyrat e caktuara të zbatohen. Njëherit rregullisht komunikon me moderatorin dhe e informon atë për rrjedhën e punës.

Vetëm para seancës organizohet edhe një takim me Grupin operativ për të kontrolluar nëse gjithçka është e përgatitur për seancën e radhës dhe për tu marrë vesh për rolet dhe detyrat e secilit anëtar gjatë seancës. Shqyrtohen rendi i ditës dhe specifikat e seancës, diskutohet





për sfidat të cilat ajo i bart dhe merren parasysh skenarë të mundshëm. Seanca e ardhme e forumit fillon me prezantimin e aktiviteteve të grupeve punuese.

Koha në mes seancave shfrytëzohet edhe për aktivitete promovuese dhe për njoftime të qytetarëve. Personi për marrëdhënie me publik ka për detyrë të përgatit dhe të distribuojë informatë mbi ecurinë e forumit dhe rezultatet e seancës deri të publiku. Është e dëshirueshme që të organizohen edhe paraqitje në mediet lokale dhe, nëse ekziston mundësia, në emision të hapur me qytetarë në të cilin ata do të kishin mundësi për pyetje. Disa ditë para seancës së radhës dërgohet informacion deri te mediet për qëllimin e seancës dhe ftohen qytetarët që të marrin pjesë në seancë. Buletinet e forumeve përgatiten dhe distribuohen gjatë seancës dhe pas saj. Grupi operativ është i kyçur në mënyrë aktive në dërgimin e ftesave dhe në mobilizimin e qytetarëve për pjesëmarrje në seancën e radhës, duke përdorur teknika të ndryshme.

Në të gjitha seancat e forumit dhe në të gjitha ngjarjet midis dy seancave mbahet procesverbal.

#### • Partneritetet në forum

Thelbi i procesit të forumit është të zhvillohet pjesëmarrje participuese, në të cilën pjesëmarrësit, me përfshirjen e drejtpërdrejtë të qytetarëve, do të mund të formojnë fillimisht partneritete joformale e më pas edhe formale. Forumi është vend ku takohen OJQ të ndryshme, përfaqësues të sektorit të biznesit, qytetarë, institucione lokale, etj. dhe bashkërisht i analizojnë problemet dhe gjejnë zgjidhje. Përfaqësuesit e OJQ-ve, me njohuritë dhe aftësitë e tyre, duhet të kenë rol të rëndësishëm në identifikimin dhe renditjen e problemeve, sektori i biznesit në gjetjen e interesave financiare, si të komunës ashtu edhe të pjesëmarrjes së vet dhe të strukturave të tjera socio-ekonomike. Në këtë kontekst përforcohen kapacitetet edhe të qytetarëve edhe të komunës për zhvillimin e projekteve dhe për rritjen e transparencës, sepse forumi e pasqyron strukturën e komunës (strukturën etnike, gjinore, sociale, të moshës etj.).

p.sh. forumi në komunën e Strumicës është shembull i veçantë për bashkëpunimin në mes sektorit të biznesit, aktiviteteve të sektorit jo-qeveritar dhe kishës. Për projektin që u votua nga forumi në seancën e fundit të forumit (themelimi i qendrës për rehabilitim dhe risocializim të konsumuesve të mjeteve narkotike dhe të alkoolit "Pokrov") komuniteti i biznesit i kësaj komune e dhuroi pjesën më të madhe të pajisjeve, ndërsa përfaqësuesit e kishës ishin iniciatorët kryesor, ndërkohë që sektori jo-qeveritar ishte bartës i projektit.

#### • Forumet dhe publiku

Procesi i forumit, vetvetiu, nuk është i mjaftueshëm. Procesi i vendosjes demokratike të cilin e promovojnë Forumet duhet të jetë pjesë e jetës së përditshme të qytetarëve të komunës. Kjo nënkupton se banorët e komunës, dhe në përgjithësi qytetarët, duhet ta dinë, ta njohin, dhe të marrin pjesë aktive në procesin e forumit. Për këtë arsye, është e nevojshme që zbatuesi e procesit të vendosin marrëdhënie aktive dhe obliguese ndaj publikut, nëpërmjet mobilizimit, animacionit, prezantimit dhe njohjes së qytetarëve me Forumet.



## Lista e Anekseve (të dhënë në CD)

Aneks 1	- Përshkrimi i detyrave të punës për moderator	Aneks 20	- Rendi i ditës i seancës së dytë të forumit për forumin buxhetor
Aneks 2	- Shpallje publike për zgjidhjen e ko-moderatorit	Aneks 21	- Formë për projekt propozim
Aneks 3	- Përshkrimi i detyrave të punës për ko-moderator	Aneks 22	- Rendi i ditës për seancën e tretë të forumit për forumin e projektit
Aneks 4	- Përshkrimi i detyrave të punës së anëtarëve të Grupit operativ	Aneks 23	- Rendi i ditës për seancën e tretë të forumit për forumin buxhetor me bashkësitë lokale dhe urbane
Aneks 5	- Shembull për ftesë drejtuar medieje lokale	Aneks 24	- Rendi i ditës për seancën e tretë të forumit për forumin buxhetor pa bashkësitë lokale dhe urbane
Aneks 6	- Format për regjistrimin e veprimtarive të medieje	Aneks 25	- Shembull i rendit të ditës për seancën e katërt të forumit për forumin e projektit
Aneks 7	-Përshkrimi i detyrave të punës së personit për marrëdhënie me publikun	Aneks 26	- Rendi i ditës i seancës së katërt të forumit për forumin buxhetor me bashkësi lokale dhe urbane
Aneks 8	- Shembull për pllakate (afishe)	Aneks 27	- Rendi i ditës për seancën e katërt të forumit për forumin buxhetor pa bashkësitë lokale dhe urbane
Aneks 9a dhe 9b	- Shembull për fletushkë (flyer)	Aneks 28	- Rregullat për zgjedhjen e projekteve
Aneks 10a dhe 10b	- Shembull për buletin	Aneks 29	- Formë e fletëvotimit
Aneks 11	- Shembull i rendit të ditës për seancën e parë të forumit projektues	Aneks 30	- Tabela për vlerësim
Aneks 12	- Shembull i rendit të ditës për seancën e parë të forumit nga forumi ndër-komunal	Aneks 31	- Shembull i rendit të ditës për seancën e pestë të forumit për forumin e projektit
Aneks 13	- Rendi i ditës për seancën e parë të forumit për forum tematik	Aneks 32	- Shembull i rendit të ditës për seancën e pestë të forumit për forumin buxhetor
Aneks 14	- Shembull për rendin e ditës për seancën e parë të forumit nga forumi buxhetor	Aneks 33	- Përshkrimi i detyrave të punës së koordinatorit të projektit
Aneks 15	- Parimet e punës së forumit	Aneks 34	- Rendi i ditës për seancën e forumit në vijim
Aneks 16	- Kriteret për zgjidhjen e projekteve	Aneks 35	- Formë për procesverbal nga seanca e forumit
Aneks 17	- Formë për propozim-koncept		
Aneks 18	- Kushtet për bartës të projektit		
Aneks 19	- Shembull për rendin e ditës për seancën e dytë të forumit nga forumi i projektit		